


Në vitin 1929 Malaparte shkon në Moskë për të shkruar librin e tij "Teknika e grushtit të shtetit". Në qendër të interesit të tij ishte pikërisht bota e lartë sovjetike: njerëzit, të cilët dhjetë vite më parë kishin përmbysur carin dhe tani ishin shndërruar në një aristokraci të re. Ai përshkruan ballot, drekat solemne, flet për skandalet dhe intrigat e pushtetarëve sovjetikë. Kjo kronikë e jashtëzakonshme e jetës komuniste u botua për herë të parë 14 vjet pas vdekjes së autorit, më 1971.

BANKET SHKRIMTARËSH

nga Curzio Malaparte

në shqip nga Aurel Plasari



ROMANI "LULET E KRIPËS" - DHE LABIRINTHET E TIPOLOGJISË ROMANORE TË JAKOV XOXËS

nga Behar Gjoka

Ribotimi i romanit *Lulet e kripës* (ndonëse dikur qe botuar me titullin *Lulja e kripës*), të shkrimtarit Jakov Xoxa, na jep mundësinë për të prekur magjinë e prozës, të marrë në kontekst me veprën letrare të autorit, por pandarazi të kontributit të dhënë në tipologjinë e romanit, në kuadër të letërsisë bashkëkohore shqipe.

(fq. 4)

Teksti biblik përballë sprovës së shqipërimin e përshtatjes në autorë e vepra të letërsisë së vjetër shqipe (shekujt XVI-XVII)

nga Evalda PACI

Përkthimet e tekstit biblik në gjuhët e Evropës kanë qenë e mbeten objekt i një vëzhgimi në thelb ndërdisiplinor, po që nuk mund të mos kenë prioritarë një përmasë që lidhet me një vetëdije të natyrshme që në syrin dhe botëkuptimin e përpiluesit a përpiluesve reflektohet në disa elemente përmbajtësore dhe teknike.

(fq. 6)

Një dashuri si e Leonidit dhe Myrvejlit

(refleksion mbi librin "Letra grues seme të vdekun" të Gjovalin Gjadrit)

nga Liridon Mulaj

Tetëdhjetë vite më parë, një inxhinier urash i kthyer nga Austria në Tiranë, dashurohet me Zejnepin, të bijën e Abdi bej Toptanit dhe që nga këtu nis saga e një jete të pësjtjelluar e të rrëmbyeshme e cila teksta rrëfëhet rresht pas rreshti...

(fq. 11)

POEZI E OBSESIONIT ESTETIK DHE E PANIKUT POSTMODERNIST

nga Milazim Krasniqi


(fq. 12)

...në poezinë e Sali Bashotës, shumë shpesh paniku postmodernist kombinohet me idealizmin modernist, më saktë me konceptimin romantik për poetin si një lloj demiurgu, i cili ka rol të veçantë dhe mbase edhe mistik në misionin e tij për ta zbuluar të bukurën në natyrë, në jetë dhe veçmas në gjuhë. Poeti mbetet për Bashotën një institucion që humanizon, që transmeton fisnikëri e dhimbje, ndonëse mbetet i moskuptuar.

SULEJMAN PITARKA - QIRIRI I NDEZUR I ARTIT

nga Xhevair Lleshi

(fq. 10)



A ËSHTË REDAKTIMI ART I HUMBUR?

nga Nick Ripatrazzone

(fq. 14)

OKSIMORON

cikël poetik nga

Maklena F. Nika



NUK JAM AI QË SHEH

cikël poetik nga

Agim Mato

8 MARS 1939 —
TETË VAJZA
TË INSTITUTIT
FEMËROR "NANA
MBRETËRESHË"

Në vitin 1929 Malaparte shkon në Moskë për të shkruar librin e tij "Teknika e grushtit të shtetit". Një gazetar magjepsës italian, i cili ishte atëhere në kulmin e lavdisë së tij dhe kishte mundësinë të hynte në shtëpitë dhe kabinetet e nëpunësve të lartë. Në qendër të interesit të tij ishte pikërisht bota e lartë sovjetike: njerëzit, të cilët dhjetë vite më parë kishin përmbysur carin dhe tani ishin shndërruar në një aristokraci të re. Ai përshkruan ballot, drekat solemne, flet për skandalet dhe intrigat e pushtetarëve sovjetikë. Kjo kronikë e jashtëzakonshme e jetës komuniste u botua për herë të parë 14 vjet pas vdekjes së autorit, më 1971.

BANKET SHKRIMTARËSH

nga Curzio Malaparte (1898-1957)

në shqip nga Aurel Plasari

Po asaj mbrëmjeje vajta në gostinë që shtronte për mua Bashkimi i Shkrimtarëve të Moskës. Gjatë darkës të ftuarit më pyesnin tejpërtej tryezës, athua se qenë gjyqtarë. I ulur para pjatës sime dhe gotës sime, isha krejt si një i pandehur, ndërsa gjyqtarët më bërtisnin nga njëri skaj i tryezës në tjetrin:

-Ç'bëjnë shkrimtarët tuaj, në Europën tuaj të mallkuar?

Përgjigjesha:

-Hanë arin e mbretit Midias, shllapuriten në dhjamin kapitalist.

-Ha-ha-ha! - gajaseshin ata pa e përmbajtur dot gazin.

-Na falni, *dorogoj* Malaparte, a është e vërtetë që shkrimtarët në Europë janë të gjithë të korruptuar deri në palcë?

Përgjigjesha:

-E vërtetë, janë të kalbur dhe qelben erë, ata drej këllyshë kurvash!

-Ha-ha-ha! - gajaseshin të gjithë, rreth tryezës së gjatë, duke qeshur me lot dhe duke m'i ngulur sytë e tyre që digjeshin.

Demjan Bjedni, kreu i Lidhjes së të Paperëndive, të *Bjezbozbnikëve*, kreu i luftës kundër fesë, Demjan Bjedni, armiku i Zotit, autori i *Ungjillit simbas Shën Damianit*, më pyeste skaj më skaj tryezës duke mbajtur me të dyja duart barkun e ngjallmë e të flashkët:

-Si jetojnë poetët në Europë? Është e vërtetë që i varrosin nëpër burgjet kapitaliste?

Përgjigjesha:

-Cilët poetë?

-Poetët e vërtetë, - thërriste Demjan Bjedni, - poetët proletarë, ata që këndojnë të varfrit, të mjerët, plebejtë.

Përgjigjesha:

-Në Europë poetët nuk këndojnë aspak të varfrit, të mjerët, plebejtë. Ata këndojnë ç'kanë kënduar gjithmonë tërë poetët, duke nisur nga Homeri: këndojnë retë, lulet, sytë e grave, bilbilat, bukurinë fatale të Helenës dhe armët shkëlqimtare të Akilit.

-Ah, se ç'skotë e mallkuar! - gërthiste Demjan Bjedni.

-Të mallkuar! Të mallkuar! - gërthistnin në kor të gjithë rreth tryezës.

Ndërsa unë:

-Posi, posi, mallkuar qofshin, mallkuar poetët borgjezë që këndojnë Aleksandrin dhe Qezarin dhe Augustin, që këndojnë Lesbjen dhe Laurën, shtyllat dorike dhe kapitelet korintiane, Afërditat dhe Erosët, gurët e çmuar, parfumerat, verërat e Francës e të Spanjës, kufomat e stolisura n'ar e në purpur të mbretërve e të mbretërshave, gjethet e bryllëta të pemëve dhe fytyrën vezullimtare të Perëndisë!

Ata të gjithë kukuriseshin në mënyrë trashanike, duke i rënë njëri tjetrit në sup, kurse unë ia ngulja sytë në fund të tryezës fytyrës së zbehtë e të trishtë të Vladimir Majakovskit.

-Po ç'këndojnë, vallë, poetët në Rusi? - pyeta befas me zë të lartë.

Dhe të gjithë papritmas heshtnin, në kohë e sipër që një riosh shtatlartë e i dobët ngrihej. Kishte flokë të zez sterrë dhe krela-krela, ballin të lartë e të bardhë, gojën të gjerë me buzë të holla e të kuqe.

-Ne këndojmë aromën e tallashit të hekurit, - tha ai, - aromën e djersës njerëzore në uzinat sovjetike

plot me punëtorë të dehur nga lodhja, këndojmë duart me kallo, mjekrat e parruara, sytë e zjarrtë të burrave të lakuritur para flakëve të furnaltave, këndojmë planin pesëvjeçar, traktorët, parmendat mekanike, çekanët, kudhurat, gjeninë e Stalinit dhe flamujt e kuq që valëviten mbi oxhakët tanë.

-Ha-ha-ha! - kukurisa unë duke qeshur në mënyrë trashanike. - Po mandej? Ç'këndojnë tjetër poetët e Rusisë?

Majakovski u ngrit e tha:

-Ne këndojmë fytyrën gjithë dritë të Leninit dhe njerëzit e zjarrtë që Uilliam Blejku shihte tek shkridheshin mbi valët e Atlantikut.

-Ha-ha-ha! - gajasesha unë duke shtrirë krahët drejt Majakovskit. - Ç'këndoje ti gjatë udhëtimit tënd në Amerikë? Këndoje rrokaqiejt e Nju Jorkut, derrat e Çikagos, rimorkiatorin e lumit Hudson, zezakët e Harlemit! Ha-ha-ha!

-Këndoja rrokaqiejt që Lenini, pak para se të vdiste, vizatonte me dorë të dridhur të fletë të mëdha letre, - tha Majakovski.

-E ke gabim, - bërtita unë, - Lenini vizatonte kulla vigane Eiffel!

-Jo, jo, - ma kthenin gjithë të ftuarit, - Lenini vizatonte rrokaqiej!

-Ha-ha-ha! - ua ktheja unë, - pra Lenini këndonte edhe lavdinë e Amerikës? Këtë kënduakan poetët në Rusi? Lavdinë e Amerikës?

-Jo! - ma priti Demjan Bjedni duke brofur në këmbë. - Në Rusinë sovjetike poetët këndojnë punëtorët, ingranazhet, rripat e transmisionit, pistonat, gizën përvëluese, çelikon e kalitur, qytetet pa Perëndi, vdekjen e Perëndisë, mallkimin e Perëndisë!

Qeshja, duke u mbështetur për shpinore të karriges sime, dhe ulërija:

-Ah! Mallkuar qofshin poetët, të gjithë poetët, borgjezë e proletarë, Homer e Virgjil, Dante e Petrarkë, Shekspir e Rasin, Bllok e Jesenin, edhe ti Demjan Bjedni, edhe ti Majakovski, edhe ti..., - duke iu drejtuar një poeti të ri ulur pranë meje, - edhe ti... si e ke emrin?

Djaloshi më vështroi e u përgjigj:

-Ivan Korov.

Dhe unë që vijoja duke qeshur:

-Posi, mallkuar qofsh edhe ti, Ivan Korov, mallkuar qofshin të gjithë poetët, mallkuar poetët borgjezë që nuk këndojnë planin pesëvjeçar, burrat e zhveshur cullak para grykave të furnaltave, flamujt e kuq që valëviten mbi oxhakët e uzinave, dhe mallkuar poetët proletarë, mallkuar qofshi edhe ju vetë, poetë të Rusisë së Leninit, që nuk këndonin retë, lulet, bilbilat, gurët e çmuar, bukurinë fatale të Helenës dhe patërshanën e Akilit, makinat luksoze dhe buzët bojëgjake të Barbara Hjutonit! Të gjithë poetët mallkuar qofshin!

Ata qeshnin të gjithë, rreth meje, duke m'i ngulur sytë e tyre shkëndijues, ndërsa Demjan Bjedni ngrinte gotën duke bërtitur:

-Për shëndetin e Europës së kalbur, për Europën e kurvëruar!

Ngrija edhe unë gotën time:


-Për shëndetin e Europës së kalbur!

Dhe të gjithë qeshnin. Majakovski më ngulte sytë e tij të trishtë tejpërtej tryeze.

Kur dolëm kishte gdhirë. Çapiteshim në heshtje, Majakovski dhe unë, ndërsa qielli ishte i bardhë, pakëz i zhubravitur atje tej, mbi kupolat e Vasili Bllazhenit, dukej si qiell prej letre të hollë mbështjellëse. Mbi kullat e Kremlinit flamujt e kuq zbeheshin në dritësimin e lodhur të reflektorëve elektrikë, që zjarri i trëndafilte e i butë i agimit e



Demjan Bjedni



fikte pak-nga-pak. Pemët ishin të gjelbra, gjethet që shndrinin nga vesa përthyenin si në pasqyrë qiellin e bardhë, zogjtë këndonin në gjethnajat e virgjëra pranverore, ndërsa unë i thosha Majakovskit:

-Dëgjo, poetët këndojnë mes gjetheve të pemëve.

-Uilljam Blejku i shihte engjëjt të ulur nëpër degët e pemëve, - thoshte Majakovski.

-Hesht, është e ndaluar të flitet për engjëjt në Rusi.

-Edhe në Europë është ndaluar të flitet për engjëjt?

-Po, edhe në Europë, - përgjigjesha.

Ecnim përmes *Kitaj Gorodit*, Qytetit tartar. Hapat tanë kumbonin pikëllueshëm në kalldrëmin e shkretët. Kur në *Nikolskaja* kaluam para kishës së vogël kushtuar Shën Nikollës, Patroni i Rusisë së Shenjtë, thashë:

-Shën Nikolla ishte nga Bari, në Pulje, ishte shenjtor italian.

-Shenjtorët nuk kanë atdhe, - tha Majakovski.

-Atdheu i shenjtorëve është proletariati, - thashë.

-A nuk është e vërtetë që atdheu i shenjtorëve është proletariati?

-Po, - tha Majakovski, - atdheu i tyre është skllavëria, mjerimi, uria, pislleku, vuajtjet e proletariatit, - dhe zu të qeshte duke pështyrë përdhe.

-Dje - i thashë - hyra në kishën e Nikolskajës. Shih se ç'më dhe ai prift i gjorë: - dhe i dëftova një medalje me fytyrën e Shën Nikollës. - Zu të qante

kur i thashë që isha italian. I premtova të veja në Bari për të nderur për të një qiri në varrin e patronit të Shenjtë të Rusisë.

-Dhe do të vesh? - më pyeti Majakovski me buzëqeshje shpottitëse.

-Do të vete. Ia kam premtuar.

-Shpresoj të mos nderësh një qiri edhe për mua mbi varrin e Shën Nikollës, - tha Majakovski, - s'besoj që shenjtorët mund të na ndihmojnë. Askush nuk mund ta ndihmojë tjetrin. Të lutesh për të tjerët, të vuash për të tjerët, të vdesësh për të tjerët, e gjitha kjo është kot i kotit, as që i duhet kujt. - Dhe u ndal duke më këqyrur në fytyrë me sytë e shndritshëm. Pandeh ti se unë nuk jam lodhur së vuajturi për të tjerët? Për të afërmin, për njerëzimin? Pandeh ti se njerëzimi do të fitonte gjësend po të vdisja unë për të? Pandeh ti se do të më pëlqente të vdisja për njerëzimin? Po ty vetë të pëlqen të vdesësh për të tjerët? - thirri duke më zënë për krahu.

-Jo, nuk do të më pëlqente të vdisja për të tjerët, - ai ktheva.

-Atëherë do të të pëlqente të vdisje për ty, për veten tënde?

-Jo, jo nuk do të më pëlqente të vdisja për mua, as edhe për mua. Për asgjë, po. Por për të tjerët, për llogari të të tjerëve, ose për vete, jo. Jo, me thënë atë që është. Nuk do të më pëlqente të vdisja për dikë, për diçka.

-Ah! Ah! As ty nuk do të të pëlqente të vdisje për dikë, ose për diçka, eh? - thirri Majakovski duke ma

shtrënguar krahun fort.

-Pandeh ti se as në Europë - i thashë - njerëzit nuk e shtrajnë problemin në është apo jo e drejtë të vdesësh për të tjerët?

-*Tas d'ignobles chrétiens!* - thirri Majakovski: - Tufë të krishterë të poshtër!

-Edhe ne - thashë - jemi lodhur së qeni një tufë të krishterësh të poshtër. Jemi lodhur edhe ne së vuajturi për të tjerët, së vdekuri për të tjerët, për njerëzimin, për atdheun, për revolucionin, për proletariatin, për demokracinë, për lirinë, jemi lodhur së vuajturi e së vdekuri për një barrë kauzash të fisme e të shenjta.

-Edhe ju, vërtet? - thirri Majakovski. - Por përse nuk provoni të vdisni për asgjë? Keni frikë të vdisni për asgjë, ja e vërteta, *tas d'ignobles chrétiens!*

Më këqyrte drejtazi me sy të ndritshëm, mandej u kthye, filloi të çapitej përsëri në heshtje, pakëz i kërrusur, duke luhatur krahët. Dolëm në shohin e Kuq, krejt para varrit të Leninit. Përfund sheshit kupolat e kishës së Vasili Bllazhenit shkridheshin me ngadalë prej mjegullës së blertë që qëndronte pa lëvizur mbi brigjet e lumit Moskova. Nga ana e portës së Iverskut grupet e para të punëtorëve venin në punë, të tjerë rendnin mbrapa trameve që përshkonin gjithë kërkëllima sheshin e Revolucionit. Mëngjesi i trëndafiltë bënte të vezullonin tjegullat e çative, majolikat e verdha, të blerta, të bruzta të kupolave të kishave, murin e madh që qarkonte Qytetin tartar, kullat e larta të Kremlinit, dorezën prej tunxhi të hotelit "Savoy".

Te pragu i hotelit Majakovski më zgjati dorën dhe, duke buzëqeshur, më tha me zë të ulët:


-Mallkuar të gjithë.

-Mallkuar të gjithë, - i thashë.

E ndoqa një copë herë të gjatë me sy tekta largohet me hapa të ngadaltë, shtatlartë, i hijshëm, pakëz i kërrusur dhe mëmërita nëpër dhëmbë: - Mallkuar edhe ti. - E vështroja tek ia mbante teposhtë nëpër rrugën Pushjeçnaja dhe shtrëngoja buzët për të mos e thirrur, për të mos i bërtitur që të ndalej, që të mos shkonte. Do të kisha dashur t'i rendja nga mbas, t'i vija një dorë në sup, t'i thosha me zë të ulët, gjithë përzemërsi: - Mallkuar qoftë edhe Majakovski!

Mbas disa ditësh Marika hapi derën dhje më njoftoi që Majakovski kishte vlarë veten, në dhomën e tij, ndaj të gdhirë, me një të shtënë pistolette në gojë.

Nga: Curzio Malaparte, *Balloja në Kremlin*, së afërmi në botimet "Onufri"



Vladimir Majakovski

ROMANI “LULET E KRIPËS” – DHE LABIRINTHET E TIPOLOGJISË ROMANORE TË JAKOV XOXËS

nga Behar Gjoka



Ribotimi i romanit *Lulet e kripës* (ndonëse dikur qe botuar me titullin *Lulja e kripës*), të shkrimtarit Jakov Xoxa, na jep mundësinë për të prekur magjinë e prozës, të marrë në kontekst me veprën letrare të autorit, por pandarazi të kontributit të dhënë në tipologjinë e romanit, në kuadër të letërsisë bashkëkohore shqipe. Mbijetesa e vlerave letrare, krahas formave të tjera, është e ndërvarur nga dy akte:

A – Ribotimi i teksteve letrare me vlera, që buron nga përkujdesja e politikës kulturore dhe botuese, ku përveçohet praktika e botimit të krijimtarisë së autorit prej shtëpisë botuese Enciklopedia.

B – Riliximi i veprave të autorëve të rëndësishëm, ku përfshihet kontributi i vyer i Jakov Xoxës, si prova domethënëse e vlefshmërisë së veprave letrare. Për modelet letrare në lëvrimin e romanit, duke mbetur nga mjeshtrat e tipologjisë romanore të problematikave të mprehta shoqërore dhe të sendërtuara përmes fakturës realiste.

Marrja në dorë e një vepre të ribotuar, duke përfshirë edhe materien e tekstit të hequr dikur, që përbën një objekt më vete për hulumtim, sepse na vendos në një situatë të ndërkomunikimit të konteksteve, të kohës shkrimore dhe të konteksteve të leximit, është edhe zbulimi i dritëhijeve, që shoqërojnë fatin e veprave të caktuara. Kjo rrethanë është dukshëm shpalohet në hapësirën e romanit për të cilin, Gjergj Llukash, në librin *Teoria e Romanit*, nënvizon: Vetëm në roman dhe në disa forma të tjera epike të afërta me të ndodh kujtimi krijues, i cili e qëllon dhe transformon lëndën. Rrethanat e shkrimit në kohën e monizmit, që në letërsi pati si model realizmin socialist, që e ktheu letërsinë në shërbesë, aq më tepër të një situatë simbolike, që ky libër botohet pasi shkrimtari është ndarë nga jeta, fiton një dimension tjetër dhe një mbingarkesë komplekse për ta lexuar dhe rilixuar vëmendshëm. Natyra e ndërlikuar, me lexuesin në hapësirë dhe kohë, e bën të detyrueshme hedhjen e vështrimit në disa aspekte të shenjave artistike:


- Vlera e ribotimit të romanit *Lulet e kripës*.
- Vendosjes e romani në opusin të Jakov Xoxës, si mjeshtri i romanit.
- Tiparet e veçanta, krahasimisht me romanet e letërsisë bashkëkohore.

Romani *Lulet e kripës*, ribotimi i pestë, shoqëruar me plotësime të teksteve, shënon ngjarje për autorin dhe për letërsinë shqipe. Për këtë rrethanë, në hyrje shkruhet: Siç ndodhte rëndom edhe me autorët me të shquar gjatë periudhës socialiste, katër botimet e atëhershme të këtij romani nuk kanë qenë as të plota dhe as të pacënuara, qoftë edhe nga ana ideore, qoftë edhe nga ajo artistike. (2016: Për vetë autorin, mbetet thënia emblematike “ky roman ma hëngri kokën”, pra është përjetuar si vepra e jetës, tashmë vjen në duart e lexuesit në formën e plotësuar. Nga ana tjetër, rëndësia e këtij romani dhe gjithë krijimtarisë së shkrimtarit, me letrat shqipe bashkëkohore, lidhet me një akt që evidenton praninë e censurës, e cila duhet dëshmuar kudoqë ka ndodhur, për shkak

të mospranisë së normave dogamtike të realizmit socialist. Ndaj kryesore në këtë ligjëratë do të jetë në shqyrtimin e vlerës që bart ky roman, për shenjat artistike, të përplotësuar tashmë, që e vendosin librin në një stad tjetër, të botimit dhe leximit në rrethanat e lirisë njerëzore dhe letrare. Në mesin e shenjave që ma tërhoqën vëmendjen, edhe në kushtet e riliximit të romanit të përplotësuar, është struktura romanore, e konceptuar me ndarje dhe nëndarje, në vëllime dhe libra, në kapituj dhe emërtime të tjera, të cilat shoqërojnë ato, që vetiu krijojnë atmosferën e një tabloje të plotë të kohës në harkun e luftës së fundit botërore, të shpërfaqura me tiparet tipologjike të romanit modern. Madje, kundruar në brendësi të veprës, duke shpërfaqur përmasën e një romani epike, me 888 faqe tekst, nga moria e linjave dhe ngjarjeve, si dhe nga larmia e ngjyresave të konfliktit të madh me pushtuesin, të mikrokonflikteve shoqërore të vegjëlisë me të pasurit, që pasurojnë hapësirën romanore. Prania e paratekstit të legjendës për të varfërit, por edhe e disa legjendave të tjera, të ëndrrave që shihen me sytë hapur dhe mbyllur, e sidomos të mallkimeve të Gruas së Mallkimeve, pavarësisht mbizotërimit të toneve realiste të jetës konkrete, i japin tonin dhe ngjyrat e realizmit magjik, gjë që ka mundësuar që Nafora me kriporen të jetë një lloj makonde e shkrimtarit, e ngjashme me makondën e Markesit, që tanimë duhet hetuar në të gjithë elementët e pranishëm. Befasi në vete është “loja” magjike me lulet e kripës, të cilat sipas autorit, vijnë në këto dy forma: Lulja e kripës së butë,

Lulja e kripës së egër. Po kaq befasi, përbën fakti, që ngjarjet e shtrira në kohë, me fillësë vitet '40 të shekullit të kaluar, që përkojnë me Luftën e Dytë Botërore, me luftën Italo-greke, të kryer në tokën shqiptare, ngjet në një hapësirë tepër të ngushtë, të kripores, gjolit dhe Nafariorit, që këtu fiton peshën e një simboli të fatit të qenies njerëzore dhe shqiptare në kohën më të vështirë të atij shekulli. Në këtë atmosferë, në këtë zonë, që bart filozofinë e jetës, se kripa është jeta e njeriut, e sidomos e të varfërëve, ndjehet klima e pushtuesit fashist, e forcave greke, e përhapjes së ideve komuniste, duke e mbështjellur vetë kohën imnagjinare në një vello simbolike të pazakontë. Po ashtu, vlerë më vetë, shenjon skicimi dhe portretizimi i personazheve, ku të gjithë papërrjashtim, të rritur apo fëmijë, mbeten në mendje si karaktere të spikatuara të gjithë tipet, personazhet kryesor, dytësorë apo episodik. Mbi të gjitha mjeshhtëria e linjave dhe skicimit të kraktereve, të krijimit të një klime artistike, që përgjithësisht nuk ka të bëjë me modelin e realizmit socialist, lidhet me narrativën, me pentagramin e endur mjeshhtërisht në këtë roman, ashtu si gjithë prozën e tij, e në mënyrë të veçantë në realizmin e romaneve. Kjo rrethanë e ngjyresave të narrativës së pranishme në faqet e romanit *Lulet e kripës*, ndërkaq përkon me sugjerimin e Tzvetan Todorov kur nënvizon: Nganjëherë flitet për një rrëfim të thjeshtë, të lidhur mirë dhe të natyrshëm, për një rrëfim të hershëm, që nuk i kishte cenet e rrëfimit modern, një pohim i bërë në librin *Poetika e prozës*, duke krijuar kështu një situatë të re të komunikimit me lexuesin dhe studimet letrare.

Përpjekja për ta vendosur ribotimin e romanit *Lulet e kripës* në marrëdhënie me veprën letrare, ku fillësat shpalosen me librin *Novela*, si dhe me ndonjë tekst dramatik, do të kërkonte një punë të gjatë, hulumtuese dhe interpretuese, për të prekur vatrat e ligjërit letrar. Për shkak të rrethanës specifike, që kemi në analizë ribotimin e romanit *Lulet e kripës*, në rrafshet e përfaqesjes së ndërmjetme, të labirinthit të endur prej shkrimtarit në tipologjinë e romanit, vetëmsa mund të hedhim ndonjë piketë të nivelit të përfaqësimit në përfaqje të brendshme të krijimtarisë së shkrimtarit. Jakov Xoxa, në thelbin e vetë përfaqësues, në letërsinë shqipe, ka hyrë dhe do të mbetet si prozator. Po kaq, emri i tij do të jetë i skalitur si lëvruar i romanit, që në hapësirën e vetë rrok disa përmasa, vendosjen në qendër të fatit të qenies shqiptare, në kohë dhe hapësirë, trajtimin e problemeve më të mprehta shoqërore, të sjella përmes kamerës realiste, që gjithnjë simbas studimeve letrare, në shumicën e vetë nuk ka lidhje organike me modelin e realizmit socialist, si tekst letrar. Megjithatë, në mes romaneve, Lumi i vdekur, nga lexuesi dhe studimet është përcaktuar si kryevepër, po ashtu për një pjesë të gjatë kohore ka qenë pjesë e programeve mësimore, ndërkaq që vetë autorit, për *Lulet e kripës* shprehet qartësisht se ma hëngri kokën. Në shijen e leximit, të esencës letrare që përçohet në prozën autorit, për praninë e vlerave gjuhësore të varianteve të shqipes, pak më e theksuar në tekstin Lumi i vdekur, por





Shkrimtari Jakov Xoxa midis kooperativistëve të Myzeqesë

edhe prej faktit domethënës që personazhet e Jakov Xoxës lëvizin nga njëra vepër në tjetrën, ndërkaq janë dy vepra cilësore të një shkrimtari mjeshtër, ku në të dy tekstet spikatet aftësia rrëfimtare dhe strukturore, duke bartuar fatet e personazheve, çka e bën veprën romanore pjesë të Sagës shqiptare të autorit, që janë pjesë e kurorës romanore që vënë në qendër shqiptarin, në kohë të ndryshme, të përbërë nga tre romane, të cilët ndërkohë anojnë edhe nga sendërtimi i romanit epike, duke gdhendur fytyrën e qenies shqiptare, në dritëhijet e veta. Pra, romani *Lulet e kripës*, tashmë i ribotuar, duke përfshirë materie tekste të ndaluar dikur, përfaqëson njërin nga romanet me vlerë të shkrimtarit, po kaq edhe një model të përveçëm të sendërtimit të tipologjisë romanore, që ka vënë në qendër kohën e luftës botërore, duke paraqitur një tablo të jetës së

Naforës, si një simbol i trojeve të përfshira në shtjellën e Luftës së Dytë Botërore.

Vlerë të veçantë shënon fakti i vendosjes së romanit *Lulet e Kripës*, si dhe të krijimtarisë së autorit, të romaneve *Lumi i vdekur* dhe *Juga e bardhë*, në situatë krahsimore me letërsinë e kohës, me zhvillimin e romanit, me atë letërsi që në pjesën dërrmuese u përfshi në hullinë e realizmit socialist. Qysh në krye, varësisht teksteve, këto romane janë shkruar në atë atmosferë, por më tepër duken jashtë klimës së atij modeli. Megjithatë, hetimi i kësaj situatë, do të kërkonte shqyrtime më të thelluara, më të plota në rrafshet e krahasimit ndërtekstor. Varësisht situatës, që ngërthejnë të tre tekstet romanor të autorit, vihen re ndryshime të përfillshme. Në mesin e këtyre ndryshimeve, që dëshmohen në veprën letrare të Jakov

Xoxës, në romanet e tij, do të veçonim:

Së pari: Rrokja e jetës në gjerësi, e jetës së shqiptarit, në kohë dhe hapësirë, duke vënë në epiqendër fatin e njeriut, si individ dhe shoqëri, duke skicuar pamjet më të thekura të mjerimit dhe varfërisë së skajshme.

Së dyti: Vizatimi i personazheve, si demensione karakteresh, ta gjalla dhe të plota, në ndryshim nga personazhet-hije, që mbizotërojnë në pjesën dërrmuese të romaneve që zbatuan në mënyrë të përpikshme normat e realizmit socialist.

Së treti: Pasuria gjuhësore e të tre romaneve, ku nuk përjashtohet asnjë ngjyresë e sistemit të shqipes, përbën një aspekt dhe vlerë unike të krijimtarisë së tij letrare.

Së katërti: Shenjat e realizmit, që pothuasje nuk kanë të bëjnë me kodet e realizmit socialist, përkundër asaj situatë ku letërsia shqipe, poezia dhe proza, u përfshin në zbatimin e këtyre normave.

Vepra letrare e Jakov Xoxës, pamëdyshje edhe romani *Lulet e kripës*, përfaqëson një vlerë të letërsisë bashkëkohore shqipe, për shkak të mjeshtërisë në sendërtimin e tipologjisë së romanit, realist dhe shoqërore, ma kahje të qarta të romanit epike, të figurimit deri në gdhendje të karaktereve, ndërkohë që personazhet e modelit të realizmit socialist përkrijnë me idetë dhe shpërfaqjen e tyre, si dhe për magjinë e narrativës, që ngërthen në hapësirën e vetë, gjithë visaret e gjuhës shqipe, pa përjashtuar asnjë variant të saj. Megjithatë, për sendërtimin e ngjyrave modern, është e rëndësishme ajo që pohohet nga dija letrare, e cila me kërkimet dhe hulumtimet e kryera, sjellë një përfundim të pazakontë: Modernizmi buron si reaksion ndaj utilitarizmit pozitivist dhe si vazhdimësi e romanticizmit të vonuar. Pra, modernizmi në thelbin e vet, gjë që dëshmohej si materie edhe në letërsinë shqipe, të Jakov Xoxës, pra të *Lulet e kripës*, më tepër është një formë e shprehjes së lartë intelektuale me nuanca të përfillshme të elementeve të romanticizmit dhe natyralizmit, që bart në hapësirën e tekstit ëndërrën dhe zhgënjërrën, por që përgjithësisht është në kërkim të risive, mbi të gjitha të imagjinatës, e cila ndërkaq mundëson sendërtimin e një bote moderne, në brendi dhe formë, e një letërsi të ndryshme nga pjesa tjetër, mbi të gjitha për sendërtimin e universit letrar si dëshmi realiste dhe moderne.

8 MARS 1939 — TETË VAJZA TË INSTITUTIT FEMËROR "NANA MBRETËRESHË"

Në foto janë tetë vajza mars të vitit 1939: Vera Tetova Malo (1), Mynever Fico Shuteriqi (2), Ramize Gjebrea (3), Marika Isak Vogli (4), Margarita Tutulani (5), Shpresa Hoxha Fuga (6), Persefoni Todhri Dervishi (7), Musine Kumbaro (8). Të gjitha 15-16 vjeçare (nxënëse të Institutit femëror "Nana Mbretëreshë") pjesëmarrëse në demonstratat që u zhvilluan në kryeqytet, ku i kërkohej mbretit Zog të armatoste popullin për t'i bërë ballë agresionit të pritsëm të Italisë fashiste.

Të teta këto vajza u përfshinë aktivisht në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare si ilegale, apo në formacionet partizane. Dy prej tyre, Ramize Gjebrea (3) dhe Margarita Tutulani (5) janë dëshmore të LANÇI dhe kanë titullin e lartë "Heroina e Popullit".

Pas çlirimit të vendit ato vijuan rrugën e arsimimit dhe të kulturimit duke merituar poste me rëndësi në sektorë të ndryshëm të jetës politike shoqërore të vendit. U shkolluan brenda e jashtë vendit në specialitete të ndryshme dhe arritën të barabiten me burrat në gjithë fushat e jetës.




Teksti biblik përballë sprovës së shqipërimin e përshtatjes në autorë e vepra të letërsisë së vjetër shqipe (shekujt XVI-XVII)

nga Evalda PACI

Përkthimet e tekstit biblik në gjuhët e Evropës kanë qenë e mbeten objekt i një vëzhgimi në thelb ndërdisiplinor, po që nuk mund të mos kenë prioritare një përmasë që lidhet me një vetëdije të natyrshme që në syrin dhe botëkuptimin e përpiluesit a përpiluesve reflektohet në disa elemente përmbajtësore dhe teknike. Natyrisht që dhe kërkimi a gjurmimi i një lidhjeje mes zhvillimeve të kohës që ndikojnë drejtpërdrejt në kulturën librare dhe elemente të transmetimit të dijes falë shtypshkrimit dhe inicimit të tij në disa vende evropiane duhet parë në bashkëpërkim me çka parashtrijmë zakonisht kur bëjmë fjalë për veprat që shënuan një periudhë me rëndësi për shkrimin shqip dhe modelet me të cilat ky i fundit u shënuan në pikëpamje realizimi dhe arritjesh konkrete. Janë me interes të veçantë zhvillimet gjegjëse në shekujt në të cilët kanë parë dritën e shtypit veprat e para të letërsisë së vjetër shqipe dhe pikërisht periudha që konstatohet prej vetë autorit të *Mesharit* në përmbyllje të librit të tij aq të ndërmendur në studimet tona është e shënuar nga përpjekje për reformime dhe ndryshime në konceptimin dhe realizimin e veprave të asaj natyre. Proceset mirëfilli evolutive që njohu në viset tej Adriatikut kultura e shtypshkrimit, çështja e njohjes dhe e atribuimit të të drejtave të autorit dhe rolit në këtë drejtim të vetë stampatorëve dhe botuesve nuk mund të mos kenë ndikuar në historinë konkrete të veprave mbi të cilat ndërtohet një kapitull i tërë i historisë së shkrimit shqip.^{*} Pavarësisht paqartësive që shpjegohen dhe me mungesë indicesh konkrete në lidhje me dokumentet shkrimore më të hershme të historisë së gjuhës së shkruar shqipe, një ndikim i tillë mund të gjurmohet dhe nga vetë elementet që njoftohen nga autorë të letërsisë së vjetër shqipe, ndër të cilët dallohet veçanërisht Pjetër Bogdani, përpilues i veprës *Cuneus Prophetarum* (Patavii, 1685). Një periudhë si ajo e letërsisë së vjetër shqipe, emërtuar nga disa studiues si letërsi ungjillore, por dhe ekleziastike mbart dhe një karakteristikë themelore që me të drejtë ndikon t'i atribuohen të tilla emërtime, në veçanti dy të fundit. Përdorimi i gjuhëve të vendit, aq më tepër për një lëndë që në atë kohë iu nënshtrua rishikimeve tejet përmbajtësore dhe rrënjësore nga hierarkia kishtarë e kohës, përbën të parën premisë për t'u konsideruar bashkë me faktin e peshimit të shkallës së përshtatshmërisë së teksteve në fjalë për botimet në të cilat dhe panë dritën e botimit. Shekulli në të cilin botohet libri i Gjon Buzukut në të vërtetë shënohet nga ndryshime që po të shihen me një sy veçanërisht kritik dhe në kërkim të një lineariteti të jutifikueshëm, bëjnë të mendosh për rishikime pikëpamjesh dhe mendimesh nga vetë përpiluesit e indekseve të veprave që duhej të ndaloheshin për konsultim a përdorim. Bibla në gjuhët e vendit nuk

* Castellani C., *I privilegi di stampa e la proprietà letteraria in Venezia*, në «Archivio veneto», XXXVI, 1888.

duket se ka përherë të njëjtin fat dhe ndërkohë do të shihet se revizionimit në kuptimin e mirëfilltë të fjalës do t'i nënshtrohet *Vulgata* vetë, e cilësuar dhe si *Vulgata Sistoklementine* dhe që duket që ka pasur një përhapje të gjerë në viset italice pikërisht në këtë periudhë.[†] Do të jetë po ky shekull që do të karakterizohet dhe nga zhvillime të lidhura me vetë frymën e epokës së emërtuar si e Reformës dhe e Kundërreformës, zhvillime të konkretizuara nga përkthime të teksteve biblike në referim dhe qasje të qartë ndaj gjuhësh të



konsideruara burimore: ebraishtja, greqishtja e vjetër etj.

Trajtimi i shqipërimin të tekstit biblik në veprat e letërsisë së vjetër shqipe kërkon detyrimisht konsiderimin e një faktori që njëkohësisht hedh dritë mbi formimin dhe njohuritë konkrete të autorëve përkatës mbi modelet e kohës dhe përafrimin me një përmbajtje që pikërisht në këtë periudhë bëhet herë pas here objekt i një vëmendjeje revizionimi në pikëpamje të brendisë dhe elementeve të tjera ndërtimore. Një faktor i tillë që ofron dhe një fushë të gjerë diskutimi është pikërisht ai i burimeve referenciale që dhe ndryshojnë

† Barbieri E., Zardin D., *Libri, biblioteche e cultura nell'Italia del Cinque e Seicento*, Einaudi, Torino, f.36.

në një hapësirë kohore që ndan realizimin e librit të Gjon Buzukut (1555) me variantet doktrinare të Pjetër Budit, të ribotuara dhe pas vdekjes së tij, ndërkohë dhe me mbështetjen e Kongregacionit të Propaganda Fide-s. Në këtë hark kohor pikërisht në lidhje me librin dhe kulturën e religjionit shënohen ngjarje të diktuara nga rrethana mjaft specifike, që shoqërohen nga arritje konkrete në dy linja që kanë të bëjnë si me kishën e Romës, si me prirje që u mbështetën në krye të herës nga ithtarë të protestantizmit në Evropë. Është një periudhë në të cilën konkurrohet mirëfilli për njohjen sa më të mirë të burimeve të teksteve biblike, për brendësim sa më të thellë të gjuhëve të vjetra në të cilat figuronin variante me rëndësi për ezegjezën biblike dhe interpretimin tekstor të vetë pasazheve të Biblës, për qasje sa më autentike dhe sigurisht kompetente ndaj tekstit origjinar dhe elementeve që duhen receiptuar prej tij. *Vulgata latine* mbetet një burim themelor nëse bëhet fjalë për qasje që hedhin dritë mbi sjelljen besnike të tekstit e të mesazhit biblik në shqipen e kohës, ndërkohë variante të Psalmeve dokumentohen pothuaj në të gjitha veprat e kësaj letërsie, sigurisht në mënyra të ndryshme paraqitjeje, e një diversitet i tillë diktohet mandej nga natyra e botimit dhe shkalla e koncizitetit që duhej të respektonte autori. *Vulgata*

latine është korpusi tekstor mbizotërues në pikëpamje referencialiteti dhe jo pak gjurmime qoftë dhe në pikëpamje të ndikimeve që dëshmojnë nëse studiohen në sisteme të caktuara gjuhësore në një vështrim krahasues mes gjuhëve, e dëshmojnë një fakt të tillë. Për këdo që e njeh nga afër ndërtimin e *Mesharit*, psalmet zënë një vend të konsiderueshëm të përmbajtjes së pjesës së parë e jo vetëm në atë ndarje që u kushtohet plotësisht të ashtuquajturve *psalma peneciale*.[‡]

Studimet mbi tekstet e vjetra shqipe janë dalluar dhe nga prirja për të nënvizuar a deduktuar ndikime të kuptueshme nëse bëhet fjalë për zhvillime që lidhen me historinë e besimit të krishterë dhe me reflektimin e reformave që ndërmori kisha e Romës gjatë Pesëqindës dhe më tej. Kultura librare e kohës, por dhe zgjimi i një vetëdijeje kombëtare që receiptohet në pasazhe të caktuara të veprave të letërsisë së vjetër shqipe bën të mundur të rikonstatohet dhe tash një fakt i tillë, si një element që vetëm se risjell në vëmendjen tonë idenë e një shkrimtarie që ruan tipare origjinaliteti që sigurisht tekstet qartësisht të përcaktuara që bëjnë pjesë në të nuk e zbehin. Vlerësimi objektiv i një pune kryesisht përkthimi në vepra konkrete të letërsisë së vjetër shqipe gjithashtu përbën një faktor për t'u marrë në konsideratë sa herë ndërmerret dhe një analizë e kujdesshme mbi brendinë, ndërtimin dhe modelin a modelet që çdo autor kishte si referim në proces të punës për përpilimin aspak të lehtë që kishte marrë përsipër.

Po aq sa është diskutuar dhe në lidhje me natyrën e mirëfilltë të ekzemplarëve të veçantë me të cilët përfaqësohet kjo letërsi, po aq sa vijon të paraqitet sfiduese ideja e rizbulimit të modeleve analoge në ndërtim dhe natyrë tekstore, edhe vetë koncepti i përcaktimit të autenticitetit të teksteve që përbëjnë lëndën parësore mbi të cilët rindërtojmë prej vitesh arsyetime dhe interpretime kryesisht të natyrës filologjike, përbën një prej argumenteve që pikësepari gjen mundësi të rimerret dhe falë faktorëve që me kalimin e kohës bënë më të afërt studimin përmbajtësor të tyre, në disa pikëpamje dhe mënyra vështrimi.

Një hap i domosdoshëm që u hodh mbas përpjekjesh disavjeçare për të njohur nga afër veprat dhe kontekstin historik që shoqëroi realizimin e tyre

‡ *Meshari, botim kritik i përgatitur nga E. Çabej*, Tiranë, 1968, f.41/b-49/a.


është vetë transkribimi i secilës, i vënë zakonisht krahas riprodhimit fotomekanik të vetë përmbajtjes, duke qenë se ndërkohë dhe realizuesit e tyre dhe sot e kësaj dite vijojnë të hulumtojnë në kërkim të rrethanave konkrete që e bëjnë dhe periudhën në fjalë më të prekshme në ngjarje dhe realitetin që i karakterizon.

Përkthimi i tekstit biblik i vëzhguar në përpilime të Pesëqindës e më tej akoma, paraqet pa dyshim një kompleksitet interesash studimore nëse kemi parasysh që dhe nga vepra në vepër gjurmohen tipare të lidhura me ndryshime konkrete që reflektohen në natyrën e librave që e përfaqësojnë letërsinë e vjetër shqipe dhe që mund të shpjegojnë më mirë dhe natyrën unike të disa prej tyre. Sidomos në raste të përpilimit të doracakëve doktrinarë e që pikënisjen e kanë në variantet e Roberto Bellarminos S.I., nuk mënjanohet dot prirja për ndërtime që flasin më qartë mbi formimin e autorit që ndërmerr një sprovë të tillë. Një fakt i tillë dëshmohej në botimet që njohim e që kapërcejnë Shtatëqindën nëse kemi parasysh dhe variantin dygjuhësh që arrin të realizojë së pari në vitin 1845 Atë G. Guagliata, një jezuit që reflekton në mënyrën e vet dhe përpjekje për të shpënë më tej një traditë që zë fill me Pjetër Budin e që në botimet më të para shihet se mbështetet nga editorë privatë. Raportin me tekstin biblik e përcakton më së pari natyra e veprës e kur bëhet fjalë për vepërza që në pamje të parë duken të paracaktuara për një përdorim të natyrës didaktike, një fakt i tillë mund të gjurmohet njëllor, dhe pse në tekste më të përcaktuara në disa pikëpamje. Një dëshmi të qartë e jep varianti më i parë i botimit të Doktrinës së kërshenë të Pjetër Budit(1618), në të cilin gjurmohen fraza latine të cilat dhe ndiqen po aty nga shqipërimi gjegjës, me gjasë një kontribut i vetë përpiluesit. Po në këtë variant paraqitet rasti jo pak herë të konstatohen përdorime që dhe pse mund të jenë kalkime fjalësh nga gjuha latine, formojnë natyrshëm një spektër terminologjik e semantik që i shkon më së miri formatit të një doracaku doktrinar. Katekeza e Budit karakterizohet nga referime permanente ndaj Ungjijve e një fakt i tillë përveç se orienton në njohjen më të mirë të brendisë së veprës së tij, bën të mundur dhe qasjen me pasazhe të ngjashme me një referent paraardhës si ai i *Mesharit*(1555).[§]

Sprova me shqipërimin e tekstit biblik kanë kaluar pothuaj të gjithë autorët e kësaj letërsie: jo të thjeshtë e ka pasur ndërmartjen dhe autori i *Cuneus prophetarum*(Patavii, 1685), që dhe pse duket se ka disponuar tjetër lirshmëri në pikëpamje të shtrirjes përmbajtësore dhe shtjellimit të kreteve përkatës të veprës së tij, natyrisht që ka respektuar një model libror që njihet në atë kohë dhe që kërkonte një vëmendje të madhe nga ana e Bogdanit. Në një diskutim që sigurisht do të kërkonte dhe hapësirë kohore më të gjerë, do të duhej të parashtriheshin në vijimësi çështje të origjinalitetit të përkthimit të frazave të caktuara nga ana e tij dhe prirja për të shoqëruar me interpretime thënie të përfshira në tekst;[¶] përdorime në thelb analitike, por që dëshmojnë që shqipja zotëronte dhe përveçime në lidhje me fjalë-terma që rezultojnë në variantin krahas atij në gjuhën shqipe; ndërtime që shërbyen më tej si

bazë burimore për përpilues doracakësh më të thjeshtë, por që në pikëpamje doktrinare dhe shprehësie duhet të ishin njëllor të vëmendshëm ndaj kanoneve kishtarë të kohës.

Me rëndësi mbetet në këtë drejtim theksimi i disa teksteve themelore në përbërje të Biblës e që pavarësisht nga autorët përpilues dhe periudha në të cilën iu nënshtruan modifikimeve të ndryshme, vijojnë të jenë më të rëndësishmit dhe për vëmendjen e studiuesve të letërsisë e të filologjisë së tekstit. Variante që paraqesin interes dhe në pikëpamje të studimit të nënsistemeve të veçanta mbeten pjesë të Besëlidhjes së Vjetër që më së pari i gjejmë në tekste të *Mesharit*, bashkë me indice të vlefshme që pikërisht nga vetë siglimet e përpiluesit apo autorit japin të kuptojnë dhe burimet me të cilat ky i fundit mbështeste përgatitjen e veprës në fjalë. Duhet theksuar dhe në këtë rasë që në çdo periudhë të zhvillimit të mendimit filozofik njerëzor e në veçanti kur u vu re një vijimësi e qartë vëmendjeje dhe ndaj varianteve biblike e më saktë dhe gjuhëve në të cilat ato duhet të njiheshin, brendësoheshin, përktheheshin apo përshtateshin, analiza filologjike dhe vështrimi përmbajtësor ka qenë një prirje që ka karakterizuar



çdo linjë a rrymë që koha prodhonte e që më tej bëri të mundur dhe të përvijohet një histori fort e pasur në arritje, burime dhe botime të studimeve të tekstit mbi Biblën dhe pjesët përbërëse të saj. Konsiderimi si tërësi i përmbajtjes së *Mesharit* ndër të tjera na shpie sërish drejt nënvizimit të kontributit unik dhe metodologjisë së gjurmimit tekstologjik që me largpamësi prej studiuesi të sprovuar Eqrem Çabej e dëshmoi në linjat e ndjekura jo vetëm në konceptimin e realizimit të një botimi filologjik e kritik që paraqitet ekzemplar në pikëpamje të arritshmërisë, por dhe qasjeve me vend që bën që shënimet me të cilat shpjegohen fragmente, sintagma, fjali e tekste të tëra të jenë prijës dhe në konstatimin e lidhjeve të natyrshme mes pjesëve që e përbëjnë këtë libër. Do të mund të gjurmohet i rimarrë dekalogu, qoftë dhe në tekste që u përkasin letrave të

Apostujve,^{**} një tjetër variant nëse kemi parasysh që ky i fundit do të renditet ndër tekstet tipike të pjesës së parë të librit; pasazhe nga ungjijtë që jo vetëm janë të njëjtë në pikëpamje burimore, por dhe mbeten dëshmi të konsultimit të përpiluesit me disa burime të mundshme referenciale; ndërtime të përveçme me vlerë sintagmatike që jo vetëm dëshmojnë një ndikim të qartë nga forma referenciale tipike për ligjërimin biblik dhe ungjillor, por dhe ngulitjen me kohë të përdorimit të tyre në kulturën kishtarë shqiptare.^{††} Do të jenë me të drejtë variantet e psalmeve të pëndësës që të vëna përballë teksteve në disa gjuhë, qoftë dhe në botime që diferencohen me ndonjë shekull nga realizimi i librit të sipërcituar, dëshmi e jo pak vështirësive konkrete në pikëpamje të përmbajtjes a më saktë përkimit ndaj burimit origjinar të konsultuar. Lapsuse të vëna në dukje dhe në shënimet e botimit kritik të sipërpërmendur (Tiranë, 1968) rikujtojnë rëndësinë e njohjes së paradigmave të fjalëve të caktuara, sidomos të atyre në gjuhën latine dhe që kanë një peshë të caktuar dhe në përbërje të vetë tekstit biblik në gjuhën që shërben si burim referencial. Do të jetë rasti pa dyshim të nënvizohen devijime nga kuptimi

i mirëfilltë i frazës qoftë kur përpiluesi nuk ka të qartë trajtën përfaqësuese të një fjale të caktuar(më saktë, elemente paradigmaticke të qenësishme që dallojnë një fjalë nga një tjetër dhe brenda së njëjtës ndarje kategoriale) e që ka shpënë në keqkuptime të pakthyeshme në pikëpamje të brendësisë të fjalës nga psalmi,^{**} qoftë dhe kur në përpjekjen për të përkthyer *ad litteram* nga varianti në gjuhën latine, nuk jep si duhet idenë a konceptin që në të vërtetë në atë gjuhë me të cilën është shërbyer përshkruhet në një mënyrë të caktuar shprehjeje. Psalmet përbëjnë tekste që dhe pse dallohen në pikëpamje të ndërtimit kryesisht të përcaktuar sa i përket shtrirjes së tekstit dhe koncizitetit të shprehësisë, në disa raste kanë mbartur dhe ndryshime që në thelb nuk duhet të jenë synim për të modifikuar atë çka duhet nënvizuar apo theksuar, por lidhen me vetë shprehjet që një gjuhë e caktuar zotëron në lidhje me një nocion të caktuar. Pothuaj në përmbajtjen e secilës prej veprave të letërsisë së vjetër shqipe gjinden premisa për të shtjelluar interpretime të tëra mbi shqipërimet të mundshme që vijojnë të jenë shtysë diskutimi, mbi njohjen *a priori* të një regjistri a regjistrave terminologjike që sigurisht mund të segmentohen në mjaft ndarje nëse kemi parasysh linjat që autorët ndoqën në varësi të objektit të materies së trajtuar. Merita autoriale mund të konstatojmë dhe sa i përket respektimit të emërtimeve të festave të urdhënuome, gjithashtu festave të paluajtshme, që bëjnë të mundur dhe në pikëpamje të modifikimit fonetik të trajtave të veçanta të deduktohen gjykime mbi lashtësinë e praktikimit të tyre në viset tona. Përbën një periudhë e tillë një dëshmi realizimesh që shërbyen si dëshmi e një pasurie të konsiderueshme formash e përdorimesh, gjithashtu dhe teksteve që rindërtojnë profilin e një gjuhe që bëri të renditen natyrshëm në regjistrat e kohës dhe vepra të formateve të sipërcituara, natyrisht në një linjë me prirjet e kohës dhe zhvillimet përkatëse kulturore.

praktikimit të tyre në viset tona. Përbën një periudhë e tillë një dëshmi realizimesh që shërbyen si dëshmi e një pasurie të konsiderueshme formash e përdorimesh, gjithashtu dhe teksteve që rindërtojnë profilin e një gjuhe që bëri të renditen natyrshëm në regjistrat e kohës dhe vepra të formateve të sipërcituara, natyrisht në një linjë me prirjet e kohës dhe zhvillimet përkatëse kulturore.

§ Vërej ndër të tjeradhe shqipërimin përkatës të dhënë nga Budi(DC 1618, f.22) në lidhje me frazën biblike *Beati mundo corde quoniam ipse Deum videbunt*; lumtë mpafterte ete delirete mendye e zemre pse atta cane meepaam tenezotne...

¶ Shih ndër të tjera dhe trajtimin gjegjës në *Cuneus prophetarum, botim kritik përgatitur nga A. Omari, Shkalla I, Ligj.IV, Tiranë, 2005, f.13, në lidhje me njërin nga psalmet: David Profeta ndë Salmite 66 thotë këto fjalë: Bekoftë neve Hyji, Hyji ynë bekoftë neve. Hyji do me thanë, na bekoftë neve Hyji Atë, bekoftë neve Biri, Hyji ynë përse bëm nierë, bekoftë neve Shpirti Shent.*

** *Meshari, botim kritik i përgatitur nga E.Çabej, Tiranë, 1968, f.103/b.*

†† Shih ndër të tjera dhe ndërtime sintagmatike te *Meshari, (botim kritik i cituar), Tiranë, 1968, si: Regjina e shekullit, f.27/b; Regjina e mishëriersë, f.31/b; Regjina e qiellsë, f.31/b etj.*

‡‡ Shih shënimin përkatës të E.Çabejt në lidhje me Psalmin 101 (*po aty, botim kritik i cituar, Psalmus contra invidiam, f.45/b*) që vë në dukje keqkuptimin mbi trajtën *-os*, që duhet të ishte përkthyer me kuptimin e *ashtit, eshtrës*, jo gojës: N zani të fshamëvet mive u afëruo goja eme mishit tim.

ka ditë

ka ditë
plot dritë e ajër e ngjyrë
ka ditë të diellta e të kthjellta
me kurora të dafinta

ka ditë
pa dritë e ajër e ngjyrë
ka ditë të derdhura në kotësi
pa kurora të dafinta

ka ditë të dalldisura në kapriço egoiste
të dallgëzuara, të kërrusura, të dendura

ka ditë me damarë të kuq nga dashuria
ka ditë dioniake të djersitura nga kafshërorja

ka edhe ditë të djerra nga kalbëzimi
ka edhe ditë dramatike apoloniane
ka ditë me dantella dëlirësie e mirësie
por ka edhe ditë të dehura nga kaltërimi

këto janë ditët e mia



ka net

net të nëmura për nostalgji
net të ngrata për neveri
net të ngrira për neologjizma
net të nakatosura për nënshtrim
net të ngrohta për ngadhënjim
net të narta për ndërvarësi
ner të ndenjura për ndërveprim

ka net
të lebetitura për ndijime...

këto janë netët e mia



hëna

bashkë me hënë të prita
ta shihnim të dy

ulur pezull mbi retë rastësore
të qiellit të qelibartë të janarit

kështu të krijoj magjishëm me lehtësinë më të
madhe
në imagjinatën time si kult

si kult hëne mbi qenien time dhe përtej qenies
sime
e kam gjithmone këtë hënë për ty



errësirë

gdhend dritën në ëndrrat e mia
plot ngjyresa ylberi dhe yjësie
gërmoj thellësitë e mia netëve plot hënë
tuneleve të frikërave të mia diellin fabrikoj
errësirave të mia dritën time rrëmoj
marr në duar qiellin dhe luaj me të
errësirë blu ngado



OKSIMORON

cikël poetik nga
Maklena F. Nika



mall

në sensorët vullkanikë të ndjenjave
ndiej mallin
si llavë e akullt nostalgjie

zhyt duart e përcëlluara në llavë
dhe laj fytyrën e shpërfytyruar nga pritja

kam mall
për vullkanin që krijove brenda meje

kam mall për ty
për llavën tënde që përshkoi dejet e mia



ndiej ende rëndesën e një vështrimi

ai vështrim
ajo thellësi sysh
në dritë të vagëlluar nate

ajo natë e thellë
vështrimesh
rëndon ende në kujtesë

ndiej ende rëndesën
e një vështrimi-dritë atë natë
e syve të rëndë mbi mua

e kaluara e largët

e kaluara ime nuk ekziston më
u tret në mijëra ëndërrime dhe mendime
si krijesë e huaj përballë kësaj të kaluare
e mpirë nga karboni i emocioneve të harruara

e kaluara ime m'u bë e huaj
pa e kuptuar mes gjithë këtij pështjellimi
plandosës
turrem drejt të ardhmes së panjohur
e shformësuar

në lëkurë ndiej gjithë prekjet e aromat
erërimet e mbrëmjeve dhe mëngjeseve epshore
flokët e shpupurisur dhe të erëmuar me erën e
tjetrit
dhe buzët e kafshuara pafajësisht

në sy kam gjithë vështrimet e dehura
përflakjen e fytyrave dhe instiktive mashkullore
gishtërinjtë e zverdhur nga cigaret e fikura
përgjysmë
dhe gotat e zbrazëta të verës së kuqe

në qenien time mbart gjithë të kaluarën time
që më rrëshket në pore si rërë e kadifenjtë
ndiej butësinë e rrëshkitjes si prekje fëmije
mbyll sytë dhe harroj

harroj gjithçka, gjithëkënd
harroj veten time të atyre historive
harroj ndjenjat e mia të shndërruara
në copa letrash e mesazhesh të zhubrosura

e kaluara ime mori fund



më dukesh shumë e vjetër

të kam përballë si dikur
si dikur kur këtë vjetërsirë nuk e shihja

qenie e zbardhët, lëkurë e rreshkur
rrudha horizontale heshtjeje në ballë
gojë e pabuzë mbyllur hermetikisht
mollëza të zbërdhulura të pajeta


të kam përballë si dikur
si dikur që aq shumë e re më dukej
si dikur kur mrekullohesha në sytë e tu
dhe në shkëlqimin e tyre të shndritshëm

kjo qenie shumë e vjetër më duket
tani



errësirë

gdhend dritën në ëndrrat e mia
plot ngjyresa ylberi dhe yjësie
gërmoj thellësitë e mia netëve plot hënë
tuneleve të frikërave të mia diellin fabrikoj
errësirave të mia dritën time rrëmoj
marr në duar qiellin dhe luaj me të
errësirë blu ngado



NUK JAM AI QË SHEH

cikël poetik nga

Agim Mato



E BUKURA E DHEUT

Atëherë poezia për mua ishte e Bukura e Dheut, që e pushtoi si me magji rininë time të hershme. Jetonim së bashku në të tjera dimensione, në të tjera hapësira, dhe botë të reja krijonim nga fermentimi i shpirtave tanë.

Çapiteshim në një truall mitesh, duke ngjeshur me këmbët tona dheun e përrallave të mbushur me mistere.

Hipnim në maja të thepisura ëndrrash dhe koloviteshim nëpër meridianë.

Po një ditë, perënditë e rreme, me një dekret të zi ma shqitën nga krahët të Bukurën e Dheut, dhe m'i shkulën nga shpirti një nga një të gjitha lulet dhe metaforat.

Vetmoja në qytetin që tashmë më shfaqej përsëprapthi, me detin që zhurmonte atje lart mbi Manastirin e 40 Shenjtorëve dhe qiellin të bridhte nëpër rrugë, duke hequr zvarrë retë e tij, si një karro e shkalafitur.

I trallisur nisa të bëja pazar me vdekjen, groposja motivet e lëna përgjysmë, me titujt si emra të vdekurish, gjersa shpirti i shkretuar u mbush si një varrezë dhe nata, tridhjetë vjet e gjatë, pllakosi qenien time.

LULESHQERRAT

Dëgjova zëra të më thërrisnin me ngut nga poshtë.
Ç'të kishte ndodhur?
Zgjata kokën në dritare dhe pashë sheshin e erërave të shkurtit të mbushur plot e për plot me shoqezat e mia të hershme, lulëshqerrat e sapoçelura:
"Eja, eja", tundeshin të gëzuara nën dritën e virgjër mëngjesore!

Nuk di si u injektua një padurim brenda meje dhe nisa të zbres dy e nga dy shkallët e viteve, duke braktisur kohën, i shndërruar në çdo hap, derisa mbërrita atje poshtë një fëmijë i vogël në pakohësi.

U prekja kërcellin e hajthëm, petalet ngjyrë ëndrre

dhe një lot më rrëshqiti para dëlirësisë e pafajësisë së tyre.

(I mbuloja me pëllëmbët e vogla nga frika se mos rikthehej sërish thëllimi).

Nga vinin kështu?
Nga thellësia e kujtimeve të mia apo ndonjë qenie e përrallave të fëmijërisë m'i dërgonte nga nëndheu?

U harrova gjatë si fëmijë dhe nuk kujtohesha më të ngjitesha atje lart te mosha ime e shkuar.

Ku e gjenin forcën ato lule të imta të magjepsnën psikikën time të lodhur nga jeta e të më kthenin atje ku pata skicuar bukurinë e shpirtit dhe ëndrrat?

Sarandë, shkurt 2017

PARA FILLIMIT TË FESTIVALIT TË TEATROVE NË BUTRINT

Lotoret prej terrakote, të plasaritura, të çara nga kripa dhe acidi i syve njerëzorë, ndiejnë t'u njomet hiri i tragjedive prapa xhamave të muzeut në Butrint!

Përse i mblidhnin lotët e nënave, për llogari të kujt hyu arkivohej pikë-pikë dhimbja dhe hidhërimi i tyre?

Kush do ta pinte kupën e vrerit të vendosur bri të vdekurit në rravimin drejt jetës së përtejme?

Po dënesat, ulërimat, logoritë, ofshamat, ç'enë do t'i mblidhte?

Në ç'mite do të strehoheshin flokët e shkultura, faqet e gjerra dhe do të shfaqeshin në koret e vajtojçave antike të tragjedive?

Vepra e kujt tragjediani e ka radhën të luhet sot në skenën e teatrit, këtu në Butrint?

Ç' hata e lashtë do të ringjallet para nesh për t'u barabatur me tragjeditë e sotme të planetit?



NUK JAM AI QË SHEH

Nuk jam ai që sheh.

Jam tërësia e mungesave dhe atyre që nuk i arrita t'i bëj. Të gjitha i tërheq me vete e s'mund të ndahem prej tyre.

Jam gjithë ëndrrat që më kanë ndjekur si një film që nga fëmijëria e hershme.

Kisha kaq dëshira, kaq pasione! Me një ashensor drite ngjitesha në dritaren e një ylli, dhe shihja atje poshtë, si nga dritarja e Perëndisë, gjithë padrejtësitë e një ideologjie, që s'kishin të sosur.

Shihja si na veçonin sipas llojit, na mohonin liritë, të drejtat dhe fabrikonin robotë njerëzorë, të programuar në emër të një utopie.

Nuk jam ai që sheh.
Jam tërësia e mungesave dhe atyre që nuk më lanë t'i bëja në jetë.

Maj 2018

BOHEMI I FUNDIT

"Ëndrra janë...

Edhe dalin,
edhe s'dalin!"

thoshte Petroja,
aty te limani i barkave të peshkimit,
ai bohemi i fundit lëkurëzeshkët,
rob i fatit dhe ëndërrimit.

Për vete as që nuk arrinte të thurte ëndrra për jetën:
- ekрани i tyre në tru nuk i ndizej,
diku i ishte këputur filli i shpresës.

Përpiqej ta sendërtonte një ëndërr dhe më kot e priste si çelja e një luleje te koka e krevatit e t'i zbukurohej dita që gdhinte, e t'i buzëqeshte fati.

Ngruhej nga shkretëtira e gjumit dhe vinte me sytë e ënjtur në liman, me një thikë që kurrë s'e hiqte nga dora, e vetmja vegël pune që s'i ndahej.

Ulej në shkallët që zbrisnin te deti dhe pastronte peshqit e blerë nga qytetarët, për një shpërblim të vogël, simbolik, nuk ngrihej nga shkallaret.

Kur dallga ngjitej me vrull dhe i depërtonte në pantallona, hera herës nuk zmbropsej por reagoje me romuze, duke i shkukur së qeshuri të tjerët.

Atëherë porositnin një teke rakie për të dhe e pyesnin:
"Ëndrrat, ç' thonë?"

"Nuk dalin, plako!" qe përgjigjja dhe tundte ato pak qindarka që fitonte.

Një ditë, e gjetën buzë një ëndrre me sytë e hapur, të ngrirë drejt saj, me ekranin e shuar brenda shpirtit...

...Dhe asnjëri nuk iu gjend që ta qajë.

ETYDE DHE VIZATIME PSIKOLOGJIKE — 2

SULEJMAN PITARKA –
QIRIRI I NDEZUR I ARTIT

Nga Xhevair Lleshi, shkrimtar & psikolog

PAK NJOHJE PËR
PSIKOLOGJINË E ARTIT

Artistët janë «movers and shakers»

Psikologjia e artit, ashtu si dhe sociopsikologjia, mund të fillonte me shprehjen që na ka rritur të gjithëve na ishte një herë e një kohë. Art i kulluar. Atë kohë jetonte një burrë, bashkëshortja e dytë e të cilit ishte një grua e zakonshme dhe egoiste. Personazh ndryshe. Po aty edhe vajza e burrit e ëmbël dhe e sjellshme. E paharrueshmja Hirushe Kjo vajzë e ëmbël dhe e sjellshme, mësoi të duronte poshtërimet dhe të mos ngrinte krye ndaj dy motrave të saj... Përrallë? Po. Që këtej filloi arti. Arti i madh dhe i papërsëritshëm. Arti që krijoi figura të habitshme, ndër to edhe Hirushen, të cilën e bëri zanë, e çoi në një ballo të madhe dhe atje ia mori mendjen një princi të bukur, që e goditi me rrufenë e dashurisë... Gjëra të njohura? Të pabesueshme? Por aty fillon e madhërishtja, pa të cilën as arti dhe as psikologjia nuk bëjnë dot. Se e madhërishtja mbart *fuqinë e situatës*. Aty ku është njerka shtypëse, Hirushja e bindur dhe jotërheqëse dhe Hirushja e mrekullueshme. E trembur, e bukur, e mrekullueshme. Ecte, fliste dhe buzëqeshte ashtu siç ishte dhe është me të vërtetë. Pa kohë.

Zhan-Pol Sartr e pranoi premisën Hirushe dhe situatë. Të dy ecin përkrah dhe ndërtojnë të madhërishtmen. «Ne nuk mund të dallohem nga situatat tona, sepse ato na formojnë dhe vendosin për mundësitë tona.» Psikologjia e artit është një shkencë që studion ndikimin e situatave te njeriu që bëhet personazh, përkrah të madhërishtes që jeton brenda çdo njeriu, duke paraqitur interes të veçantë për mënyrën sesi ne ndikojmë te njeri-tjetri. «Jetët tona janë të lidhura nga mijëra fije të padukshme», ka thënë romancieri Herman Melvil. Psikologjia e artit ka për qëllim që t'i shpalosë këto fije. Këtë gjë bëjnë të gjithë artistët në fushën e tyre, mbi platformën e fuqisë së situatës, duke lartësuar energji të papara e të tjetërsuara.


Këtu zënë fill etydet dhe vizatimet psikologjike.

*«mover and shaker», është individi që ka një ndikim të madh në një shoqëri, për shkak të aftësive të tij për të zgjidhur gjërat shpejt dhe me sukses.

Do të vemi bashkë në Akropol, i thashë. M'u duk i lodhur. I rrahur nga era. Sytë disi të rënduar. Në cep të buzës varej një mendim, dhe rrinte aty kapur përdore me buzëqeshjen e hollë. Sulë Pitarka! Kam nja dy të fshehta që dua t'i tregoj vetëm ty. Edhe Violeta Manushi me Ilia Shytin, teksa drekonim në shtëpinë e ringritur si për pritje në Tabje, aty ku ruhen ende disa nga misteret e Beratit (tani as unë nuk e di se ç'bëhet me to!), as atyre nuk munda t'ua tregoj, sepse vera e kuqe nuk na la të shihnim dot më tej se hunda jonë. E kam vetë merak, mos ki dert. Hë, po, kemi pirë një natë aty, tek Tabja, me Sheri Mitën dhe Ferdinand Radin - i mrekullueshmi për role të pa-bukur, e deri pas orës dy të natës kemi ecur këmbadoras një orë për të gjetur qiririn e ndezur!... Dhe nuk e gjetëm dot! Qiririn e kujt? Thjesht, qiririn e ndezur të artit! Ah, po, e dëgjoj për të dytën herë. Sulë Pitarka qeshte pa zë dhe fytyra që rrezatonte një qetësi të patregueshme, i ndrinte.

Muzgu na gjeti në Akropol. Binte një dritë që sesi thyhej në shkëmbinjtë e nxehur nga fundi i majit. Dielli ishte fshehur pas faqes veriperëndimore të Shpiragut dhe tek ne vinte pak muzg i ndritshëm që t'i ndryshonte emocionet dhe të bënte për vete. Ja këtu, i thashë, është Akropoli i famshëm, ndërsa aty poshtë shkëmbi Çekbeni, rri me sytë ulur nga turpi, sepse këtej zbritën me litar korrierët që duhej të lajmëronin ushtrinë e sulltanit, ndërsa shqiptarët dhe napolitanët mërzenin nëpër ullishtë, duke pritur që portat e kështjellës të hapeshin vetiu. Dhe

po që këtej erdhën lajmëtarët osmanë dhe e vunë në gjumë pashain e fshehur në Akropol. Këtë ti mbase e ke ditur, po kështu si ta them unë nuk e ke ditur kurrë. Ai e vështronte së larti Shën Mëhillin e fshehur në gji të shkëmbit, nën Tabie, shihte çatitë e Mangalemit dhe harqet e dritës mbrëmjesore që vraponin sa nga cepi



i Goricës, mbi Atik, mbi Gjyn Gjormes, mbi Holec, mbi... Ky është qytet i llahtaritur, qeshte Sulë Pitarka. Nuk e kam njohur dot dhe më vjen mirë që e njoha me ju. Zot, çfarë mrekullie. Po më dukej si i marrosur. Nuk ngopem dot. Se si më rriten përmasat e tij. Zgjatet përpara pa fund dhe kap grykën atje tej pa filluar Çezma e Vodicës, në Mimias, duke u kreshpëruar rreth e qark me një lloj elegance kryeneçe. S'ka, jam i dashuruar tani dhe ky çast magjik s'do të më shqitet kurrë nga mendja. E jashtëzakonshme. I dëgjon zërat që vijnë nga thellësia e Shkëmbit? Nuk i dëgjoj, s'të gënjej dot. Duket sikur dikush me zë të thellë, më të thellë nga zëri im, më lexon një triptik të magjishëm të cilin s'e kisha dëgjuar kurrë më parë. Mos janë faqet e librave të moçëm? Ndoshta. Lum kush do ketë fatin ta dëgjojë këtë mrekulli kodikësh. Një perlë. Zë që vjen nga Lashtësia, nga Mesjeta. Imazh që lëvizte me shpejtësi si zëri i mrekullueshëm i Sulë Pitarkës. Më duket se nuk u çlirua kurrë nga vetvetja. Kjo ka për t'na marrë më qafë. Apo jo Sheri? Lëre, shtoi Nandi, duke i dhënë fytyrës një pamje mosaprovuese e si të egër. Përmasat e Akropolit treteshin dhe më bëhej një harmoni «zërash» gati e pashpjegueshme, duke përfutur një dritë të fshehtë, që s'dihej nga buronte. Ndoshta nga përjetësia e nëntokës së Akropolit. Ndoshta nga sterna e madhe gati mitologjike mes Akropolit...

Të dukej se ishte në një përfaqim të malluar, të etur dhe me një pamundësi të habitshme për ta rrokur. Pra, një tjetër mjegull, e hedhur vende-vende, si enkas për të detyruar që të mbeteshe pa frymë. Vello e hollë, e tejdukshme, por edhe që ta largonte «syrin e keq», të jepte mundësi të kërkoje më tej brenda asaj fshehtësie të mrekullueshme.

Sa herë vinte në Berat Sulë Pitarka, artisti i madh i skenës sonë, sillte ndërmend kohën kur u detyrua të lidhej me bazën dhe masën me rininë e Kuçovës, me teatrin dhe me naftëtarët, asaj kohe kur shkroi dramën *Heronjtë e Linasit* dhe bashkëpunonte me Fatmir Gjatën që kish premtuar se do shkruante romane mes bujqve, apo me Ismail Kadarenë që ishte mes tekstilistëve. E megjithatë e ndjente veten të braktisur Sulë Pitarka, sigurisht jo brenda vetes, por me atë që e rrethonte. Dhe kjo nuk e trishtonte, sepse, ashtu si thoshte me qetësi, është e pamundur të jem vetëm, ngaqë më rrethojnë *ata që dua*, me një kujdes të përkryer, krejt të harruar. Të ishte iluzion e gjitha kjo, se vërtet kjo botë ngjan së tepërmi me iluzionin, të gënjen dhe po aq të bën për vete. Herën tjetër do vemi bashkë te shtëpia ime në një botë të padukshme. Jetoj me imagjinatë. E kam të mrekullueshme. Hm. Më mbron nga çdo gjë e ligë. Qeshi si dinte ai. Kur t'i shohësh mendimet s'do t'u gjesh më thinja! Janë thinjur krejt mendimet e mia, pale që m'i kanë rrëmbyer të tëra dhe unë ndihem shumë mirë që mendimet e mia janë kudo.

Ata sy, për besë, atë çast nuk e fsheh dot, s'kam arritur t'i shpreh dot, përsosje rrudhash, dritë balli, shprehje mendimi. Më vjen të them me shpirt se brenda meje ushtron trysni një mirësi e madhe që më duket se ma ka dhuruar ime më. Kurrë nuk u mërzit me mua dhe me asnjë tjetër, madje ka një tipar që e kam vënë re shpesh tek njerëzit: «hiqen sikur», domethënë hiqen të mërzitur, hiqen të qeshur e çakërrqejf, hiqen sikur kanë inat... e çë tjetër? Ndaj them se larg këtyre *heqjeve* gjithçka vete mbarë. Edhe kur kishte edhe kur s'kishte ime më dukej behar! Edhe unë ashtu jam! Zot i madh!

Dhe kishte të drejtë: i tillë ishte. Nuk mund të ngopeshe dot kurrë kur e shihje. Buronte një mirësi të pavdekshme, fine, të hollë, të çmuar. Edhe kur e vura re edhe njëherë aty në Akropol, mbështetur pas murit të lashtë, mirësia e tij e patreguar nuk u tret asnjë çast, madje mund ta shihje edhe të ilditur me një dhimbje të jëratitur thellë! Dhembje e çuditshme dhe e bukur kjo e Sulë Pitarkës!

Tiranë, më 20 shkurt 2020

Një dashuri si e Leonidit dhe Myrvejlit

(refleksion mbi librin “Letra grues seme të vdekun” të
Gjovalin Gjadrit)

nga Liridon Mulaj

*“E dashuna jeme. Sot me tre shtator janë mbushë shtatë
vjet qysh se jemi martue e nuk jeton ma”*

Kështu fillon libri “Letra grues seme të vdekun” shkruar nga Gjovalin Gjadri në vitin 1941. Tetëdhjetë vite më parë, një inxhiner urash i kthyer nga Austria në Tiranë, dashurohet me Zejnepin, të bijën e Abdi bej Toptanit dhe që nga këtu nis saga e një jete të pështjelluar e të rrëmbyeshme e cila teksa rrefehet rresht pas rreshti, të krijon nje lloj konfuzioni të thellë i cili të shtyt te mendosh se si është e mundur që në kaq pak vite, dy të dashuruar kapërcejnë kaq shumë pengesa e ndërsojnë shtigjeve të thella të cilat fatkeqësisht për Zejnepin, personazhin pothuajse kryesor të veprës, ngushtohen në fund deri në një zgjidhje të dhimbshme, vdekjen e saj. Teksa lexon këtë vepër elegjike, përkthyer nga gjermanishtja mjeshhtërisht në gegënishten letrare nga prof. Ardian Ndreca, të krijohet në gjoks një lëmsh i fortë dhe i pazgjidhshëm. Padurimi nis e të mbërthen dhe mendon sesi padrejtësitë e jetës shkatërrojnë ëndrrat rinore dhe padashje lidh dashurinë me dhembjen, triumfin me humbjen dhe të ndërthen frika e bestytnive të cilat jehojnë pas veshi e na thonë se historitë e mëdha të dashurisë nuk ekzistojnë e nëse po, nuk e kanë të gjatë.

Në pothuajse të gjithë letërsinë shqipe është e pamundur të gjesh një përshkrim kaq të thellë dhe të ndjeshëm të dashurisë. Këtë vajtim të paskohshëm dhe këtë lloj vuajtje deri në fatalitet që Gjovalini përjeton për humbjen e gruas tij. Një barrë e madhe faji të cilën përpara se të ja ngarkojë natyrës dhe Zotit i verbuar nga dhimbja, Leonidi (siç Gjovalini vetëquhet në libër) ja ngarkon familjes së Zejnepit të cilët mbërthyer nga frika e gjykimit të dokeve dhe zakoneve e pashmangashmërisht nga feja e kundërt, ndërpresin çdo komunikim me të bijën duke ja shtuar asaj mërzi dhe dhimbjet e kështu rrjedhimisht duke marrë pjesë drejtpërdrejtë në avancimin e sëmundjes saj e cila më vonë i merr dhe jetën. Është dëshpërimi përballë arsyes, jeta përballë vdekjes dhe dashuria përballë dhembjes. Elementë të cilët për shekuj me rradhë kanë shoqëruar letërsinë e shkruar në botë. Në këtë rrafsh, tradita e letërsisë së shkruar shqipe ka qënë e mangët, duke i drejtuar subjektet më së shumti nga kumti kombëtar dhe atdhetar gjatë periudhës së rilindjes. Drejt dashurisë për partinë gjatë regjimit komunist e duke mbërritur gjer në letërsinë bashkëkohore të pas komunizmit ku subjektet evidentuan dhe nxorrën në pah lirisht ndjenjat mes mashkullit dhe femrës. Në kohë lufte, ku Shqipëria dhe integriteti i saj varej nga fuqitë mëdha, ku lufta ishte në kulmin e saj dhe ku figura mashkullore qëndronte e pacënuar nga burrëria, Gjadri na sjell një vepër krejt tjetër, karakterizuar nga brishtësia dhe dashuria e pashoqë e cila e vë pozitën mashkullore në të tjera pozita të pakumtuara më parë. Rrjedhshmëria e

prozës, dhimbja e thellë e shprehur filozofikisht, diçka që kapërcen tej një vepre të thjeshtë letrare të atyre viteve, ku vetëm figura të mëdha të letërsisë si Ernest Koliqi guxonin e dilnin jashtë kornizave të arkaizmit ku krahas epikes që përbënte të shumtën e subjekteve të novelave, përçontë dhe nota të thella lirizmi dhe romantizmi si pjesë e pandashme e realitetve të asaj kohe në malësine e Veriut. Teksa lexoja veprën e Gjadrit, vëreja ngurimin për ti hyrë në thellësi ngjarjeve, përjetimeve rrëfyese gjatë kohës kur ishte njohur me Zejnepin. Marrëdhënien e ndërlikuar me të vjehrrin apo dhe kunatin. Kohën kur ata martohen pa miratimin e tyre dhe vitet para se Zejnepi të sëmurëj. Ka mangësi në detaje dhe kjo hera herës më revoltonte gjatë leximit të librit pasi interesi im ishte tejet i madh për të kuptuar më qartë veprimet dhe pasojat e një kulminacioni në marrëdhënien e ndërlikuar mes dy të dashuruarve. Por siç e sqaron në fund dhe vetë autori, duke mos qënë mirefilli shkrimtar, ai kishte nguruar të hynte në thellësi të detajeve nga frika e devijimit të qëllimit të vepres, e cila fatkeqësisht fillim e fund bashkangjitur dashurisë ka dhimbjen e ku përfundimi i të dyja këtyre ndjenjave sa njerëzore aq dhe hyjnore është vdekja e më pas amshimi në të cilën Gjadri nën


ndikimin e vërbërisë që i kishte shkaktuar vdekja e së shoqes rrëfen që nuk e besonte. Por me veten time këmbëngulja në idenë se nëse Gjadri do kishtë qënë shkrimtar dhe do ishte nisur nga dëshira që përtej dhimbjes, të shkruante një roman, mendoj se sot do flisnim për një kryevepër të letërsisë shqipe shkruar për dashurinë apo siç Kadareja e ka quajtur këtë libër, një himn i rrallë për gruan. Dhimbja të kaplon pashmangshëmrisht dhe e gjen veten në rolin e të pafuqishmit për të ngushëlluar, është kjo qasja që autori ka ndaj lexuesit dhe pse është e qartë se autori nuk është nisur nga ky qëllim, madje as nga qëllimi që ky libër të lexohet nga dikush por vetëm si një testament dashurie shkruar së shoqes pas vdekjes por a mundesh vallë të jesh kaq i pamëshirshëm me veten dhe njëkohësisht me lexuesin i cili e ndjen veten të pafuqishëm përballë kësaj dhimbje të përmasave tragjike? Dhe të vijnë ndërmend të gjithë rreshtat e romaneve të mëdha shkruar grave të vdekura, dhe teksa i krahason ka gjithmonë elementë dallues që të japin efekte të ndryshme, dhe pyet veten pse te Gjadri, dhimbja është kaq e fortë, kaq e pangushëllueshme? Sipas Ernesto Sabatos, ndjesia e dhimbjes pas vdekjes së Alehandrës tek romani “Mbi heronjtë dhe varret” përshkruhet kështu: *“Në atë çast që sikur t’ia shqitnin zemrën nga gjoksi dhe t’ia copëtonin për tokë, duke ia goditur me një gur, ose sikur t’ia shkullnin me një thikë çallatë dhe pastaj t’ia shqyenin me thonj”* Në vrazhdën e krahasimeve të cilat më lindën vetvetiu mbi përshkrimet e autorëve të mëdhenj mbi vdekjet e mëdha të të dashurave të zemrës hapa dhe romanin e Orhan Pamuk “Muzeu i pafajësisë ku rreshtat përshkruen për vdekjen e Fysunit i mbyll me fjalët *“Fysuni nuk kishte pësuar asnjë dëmtim në shpirtin e saj, të cilin kisha dëshiruar ta kisha gjithnjë pranë”*. Si një fëmijë i cili rend drejt krahasimit të lodrës së tij më të një moshatari të tij duke dashur të sigurohet se ajo e tija është ende më e bukura (kjo vjen për shkak se letërsinë e dua siç një fëmijë do lodrën e tij) dhe unë në këto fjali që përshkruanin dhimbjen nuk arrija të kuptoja se pse dhimbja e Gjadrit ishte

kaq sublime dhe e ngrohtë, pa ftohtësine e cila karakterizon dhimbjen në një roman të mbushur me figura letrare dhe përkujdesje stilistike. Atëherë pse dhimbja e Gjadrit ishte kaq e pangushëllueshme dhe fataliste sa te ngjante si një shteg që për fund ka një humnerë dhe ti i pashpresë e gjen veten në zgrip të saj, pa rrugëdalje? Përgjigja e pyetjes e cila është aty në çdo rresht vjen e përmbledhur qartësisht në fundin e veprës ku autori shprehet: *“Kurrkush s’mundet me e matë dhimbjen e unë mundem me thanë veç këtë, se dubet me e pasë përjetue vetë për me kuptue se çka domethanë me e pa të dashunën tande në arkivol dhe me ndëgjue fëmijën tand tue qa”* pasi e mbaron së lexuari pason vetëm heshtja e pas heshtjes pushtohesh nga frika e humbjes. Reflekton për historinë e tyre sa të bukur aq dhe tragjike. Përshkrimet dhe fjalët rrëqethëse të Gjovalinit, vendet ku ai kishtë përshkruar dhe dhimbjen e tij të pashërueshme të cilën pafundësisht rrekej ta zhbente në përpjekjet e tij pa sukses. Shembullin e pashoq të një mashkulli të dashuruar dhe të ndershem, që krejt papritur jeta e detyron të çajë mepërmes dallgët e larta të një deti të stuhishëm që lë në trupin dhe shpirtin e tij vragat e zeza të humbjes, e cila do shërohej vetëm me vdekjen *“Jeta nuk është teatër, asht një luftë, ku në fund pushtetin e ka vdekja”* shkruan Gjadri në një nga letrat drejtuar së shoqes Zejnepit dhe s’ke sesi të mos mendosh për gjithçka që të rrethon, për vlerën e dashurisë dhe burimet e saj. Për hollësitë e jetës të cilat na bëjnë të kuptojmë se çastet janë ato që përbëjnë kuptimin e saj e se mbi gjithçka dhe çdo qenie të kësaj bote qëndron ajo, dashuria.

Gjovalin Gjadri

Letra grues
seme të vdekun

Onufri



POEZI E OBSESIONIT ESTETIK DHE E PANIKUT POSTMODERNIST

nga Milazim Krasniqi



Vëllimi poetik më i ri i Sali Bashotës shënon kulminacionin artistik të tij si poet, duke na ofruar edhe një mundësi të rishikimit dhe rivlerësimit të gjithë krijimtarisë poetike të tij, që tashmë ka hyrë në decenien e katërt. Nga "Albumi i grisur" (1986) e deri te vëllimi më i ri, ndërmjet të cilëve janë edhe vëllimet, "Zogu me profil vjeshte" (1989), "Plagomë" (1994), "Dalje nga trishtimi" (1999), "Bukuri e nëmur" (2006), "Dorëshkrimi i ngjallur" (2011), "Në fillim ishte Drita" (2017), "Asnjë zë tjetër" (2018), poezia e Saliut ka ndjekur një rrugë konstante ambicioze të evoluimit artistik, duke alternuar preokupimet motivore e tematike, sigurisht nën ndryshimet që kanë ndodhur në jetën personale e shoqërore, por duke mbajtur të pandryshuar obsesionin e komunikimit si një idealizëm estetik, në morinë e komunikimeve rivale ndërpersonale.

Në këtë linjë vështrimi, të gjitha vëllimet e deritashme përbëjnë një strukturë të obsesionit estetik të tij. Edhe vëllimi "Lutja e parë e shpirtit" (2020), inkuadrohet në këtë strukturë, sigurisht duke e pasuruar atë me zhvendosje e pranëvendosje vlerash artistike, po edhe duke u imponuar si element dominant në atë strukturë komplekse, falë kulminacionit të vlerave estetike me të cilat participon.

Këtu, në këtë pikë konstatimi, jam i dyzuar ndërmjet dy opinioneve të dy studiuesve të njohur, Emil Shtajgerit dhe Jan Mukarzhovskit, që ofrojnë dy mundësi të kundërvëna të shikimit të statusit dhe të strukturës së produktit poetik. Shtajgeri pohonte, në një rast, se secila poezi është vepër artistike më vete, e pavarur nga të tjerat në të njëjtin vëllim poetik, pra funksionon edhe si strukturë e mbyllur. Ndërsa Mukarzhovski pohonte se veprat e të njëjtit autor formësojnë një strukturë unike, brenda së cilës ndodhin zhvendosje, por duke u ruajtur uniteti i saj.

Pa e minimizuar aspak qëndrimin imanent të Shtajgerit, me këtë rast do të ndjek qasjen me Mukarzhovskin, sepse më duket më e dobishme për ta hetuar evoluimin e poezisë së Sali Bashotës, e cila ka shumë elementë që barten dhe pranëvendosen nga vepra në vepër, duke e pasuruar tërësinë e duke përjashtuar vetëm ato elemente që tregohen më pak dinamike estetikisht. Mukarzhovski thotë: "Zhvillimi i strukturës individuale të veprës së autorit nuk është i tillë që të mundësojë ndryshimin e strukturës me kërcime të papritura: kontinuiteti i saj nuk ndërpritet as nga ndryshimet radikale, gjithmonë ekziston rivaliteti ndërmjet asaj që mbetet dhe asaj që vazhdon, prandaj edhe autori është i mbyllur në kufijtë e individualitetit të vet, të cilin me veprën e vet, në të vërtetë, e përsosë pandërprerë,

por pikërisht për këtë arsye nuk mund të dalë jashtë kufijve të saj." (Mukarzhovski: 207).

Pra, ndonëse vëllimi më i ri, vërtet, paraqet kulminacionin e krijimtarisë poetike të Bashotës, ai mbetet brenda kufijve strukturorë të mëparshëm, sigurisht duke provuar që ta përsosë sa më shumë vargun poetik, pa heqë dorë nga trashëgimia paraprake. Ky fakt vërehet qartësisht në format e titujve të poezive, në formën grafike të vargjeve, në shumë elementë stilistikë, në disa nga motivet qendrore dhe në objektivin qendror të komunikimit, që mbetet me synimin e një komunikativiteti relativisht të ulët, diskret, gati inhibicional, gjë që bartet si strategji poetike nga vëllimet e mëhershme.

Një vlerë konceptuale, ideologjike dhe estetike e re që imponohet më shumë në vëllimin e ri është një reagim brenda të ashtuquajturit paniku postmodernist. Pra, theksimi i humbjes së sigurisë së individit dhe kërkimi në panik i saj, është një vlerë që tashmë duket sikur konkuron më guximshëm me shtresat e vjetra të vlerave konceptuale, ideologjike dhe estetike të poezisë së Bashotës. Poezia "Parandalimi i vdekjes" inicon këto shtresëzime, me elemente tipike të panikut postmodernist:

*Sytë e kaltër të ëndrrës
I dua shumë
Si ty
Si ty
Si ty
Por ti nuk je përmallim i djegur
Nuk je as frikë
Nuk je as ikje
Nuk je as dhimbje
Mollëzat e përflakura të vetmisë
I dua shumë
Si ty
Si ty
Si ty
Por ti nuk je dashuri e çmendur
Nuk je as mëkatore
Nuk je as hije
Nuk je as vdekje e bukur*

Ky është një ligjërim poetik tipik me tharmin e panikut postmodernist brenda ligjërimin, madje edhe dukjes grafike. Subjekti lirik i stresuar, tenton të gjejë shtigje të reja të njohjes, të shpëtimit nga paniku, qoftë duke evokuar dashurinë si vlerë sublime humane, qoftë duke evokuar ëndrrat, qoftë duke u mbështetur në iluzione e vizione të brishta, që shpërbëhen dhe që vetëm ideja fikse (që mishërohet në vargjet: *si ty, si ty si ty*) arrinë t'i mbajë pezull.

Në këtë kërkim të rrugëve të njohjes e të shpëtimit, tashmë përfshihet edhe Transcendencja, sado që jo si instancë e njohjes, po si element i emocionit, më saktë panikut. Fjala vjen, operohet me nocionet libër dhe testament që kanë të bëjnë Librat e Shenjtë, por autori vetëm i evokon si nocione, ndërsa shmang referimin e ligjërimin poetik në to si instanca denotative, gjë që sërish më duket si intonacion i panikut postmodernist:


*Libri i ëndrrave
I vetmi testament
Për një lutje*

Por, ka edhe raste kur ka më shumë qartësi konceptuale në këtë kërkim, në disa poezi të këtij autori, fjala vjen në poezinë "Tri pika":

*Pika e parë
Shpirti i saj
I mëshiruar nga Zoti*

*Pika e dytë
Fytyra e saj
E mëshiruar nga Zoti*

*Pika e tretë
Buzagazi i saj
I mëshiruar nga Zoti*



Ligjërimi më i shtruar, më vizionar, vërehet lehtësisht në këso rastesh, sesa në rastet kur kombinohen pëfytirimet, idetë, përjetimet nga sfera të ndryshme jetësore e botëvështrimore të kundërvëna. Në fakt, ky është njëri nga problemet më të mëdha që ka e gjithë poezia shqipe e modernizmit, po edhe e postmodernizmit, pra, një eklektizëm konceptesh e vlerash të kundërvëna, që nxirren nga shtrati natyralë dhe futen në njëfarë shtrati prokrustial. Është pasojë e doktrinave dhe rrymimeve të kundërvëna, të pafiltruara, të pahierarhizuara, të pavlerësuara qartë, gjë që pothuajse pashmangshëm shpie drejt përjetimit agnosticist të botës. Postmodernizmi është trull shumë i plleshëm për këso pranëvendosjesh dhe këso eklektizmash. Prandaj, komunikimi më frytdhënës me publikun dhe transmetimi i një vizioni estetik më imament e më koherent për njohjen, në këtë kontekst, mbetet sfidë serioze.

Sidoqoftë, kjo ndjeshmëri postmoderniste në poezinë më të re të Bashotës, e pasuron atë konceptualisht dhe artistikisht. Brenda kësaj ndjeshmërie janë edhe mikronarracionet e subjektit lirik mbi dashurinë, vetminë, ëndrrat, hutimin, rezingantën, por edhe ironia që ndonëse jo shumë e dendur, ka raste që bashkohet në këtë frymë konceptimi postmodernist, si në poezinë: “Ideali i dyfishtë”, ku dominon ironia ndaj atyre që abuzojnë lirinë, duke qenë megallomanë, egoistë, kleptomane dhe faqezi:

*Unë jam më i vogli
Të mëdhenj jeni ju të tjerët
Që mbartni mbi supe lirinë
Asnjë stubi nuk iu ndal
Asnjë fuqi e gravitacionit të tokës
Që vërtet të dukeni të mëdhenj
Shumë të mëdhenj sa të çmendeni*

Mirëpo, në poezinë e Saliut, shumë shpesh paniku postmodernist kombinohet me idealizmin modernist, më saktë me konceptimin romantik për poetin si një lloj demiurgu, i cili ka rol të veçantë dhe mbase edhe mistik në misionin e tij për ta zbuluar të bukurën në natyrë, në jetë dhe veçmas në gjuhë. Poeti mbetet për Bashotën një institucion që humanizon, që transmeton fisnikëri e dhimbje, ndonëse mbetet i moskuptuar.

*Të jesh vetëm poet do të thotë të jesh dhimbje e përflakur
Përgjithnjë në tokën e zezë
Përgjithnjë në detin paanë
Përgjithnjë në qiellin pa yje
Të jesh vetëm poet*

Ose:
*Askush nuk i duron poetët
Ata janë si lumenjtë e giejve
Që rrjedhin brigjeve të amshimit
Askush nuk i duron poetët
Kur thurin vargje për vuajtjen e tjetrit
E për vete protestojnë vetminë e tepërt
("Askush nuk i duron poetët")*

Ndonëse ky konceptim është brenda kornizës moderniste romantike, në tërësinë e ligjërimit, edhe ky më duket sikur ligjërimit paniku, duke denoncuar çrregullimin në komunikimin e individit me shoqërinë. Ligjërimit poetik me intonacione të larta, gati me klithma, e bën bindës këtë konceptim. Sikundër që pohonte Llotmani, “nuk udhëheq vetëm tema shenjën gjuhësore, por edhe shprehja gjuhësore udhëheqë temën” (Llotman: 94.) Pra, kjo do të mund të thoshte kështu: koncepti për poetin



si iluminues e si ëndërrimtarë mbetet aktiv, por ligjërimit gjuhësor-poetik i ndryshuar për të, ndikon që edhe ai status të shihet si i ndryshuar. Saktësisht siç është në realitetin jetësor!

Për ta bërë sa më të qartë këtë raport, po u njoftoj se cikli “Imazhi i pestë Dhimbja”, me vënien e imazhit në plan të parë, i cili sikundër dihet është elementi më i ekspozuar i përjetimit postmodernist të jetës/botës, dëshmon se Bashota tashmë ka avancuar shumë në ligjërimit me këtë frymë. Intonacionet e pasuruara të vargut, të bashkuara me nivele të tjera të ligjërimit poetik, në mënyrë intuitive marrin përsipër të bëhen shenja të realitetit të kohës në të cilën jetojmë në panik, ndërmjet kaosit e anarkisë, antivlerave dhe dehumanizimit. Llotmani ka sinjalizuar moti: “Për shqyrtimin e korelacionit ritmik të intonacionit dhe semantikës së vargut, si pikë nistore duhet të shërbejë bindja që rendi ritmik-intonativ nuk është strukturë e pavarur, por është element që shërben për një varg nënstrukturash të cilat në bashkëveprim konstitutojnë sistemin unik të tekstit, i cili quhet poezi dhe i cili paraqet shenjë të përmbajtjes së caktuar dhe model të realitetit të caktuar (Llotman: 247)

Falë përvojës së gjatë si poet dhe si studiues i pasionuar i letërsisë, Sali Bashota është autor që i njeh këto vibracione intonative-ritmike, ideologjike, stilistike e sociale, prandaj edhe arrinë t’i definojë gjuhësisht në pajtim me realitetin.

Këso definimsh ka edhe për motive të tjera, veçmas për motivin e dashurisë, që është motivi dominues në këtë vëllim dhe veçmas në vëllimin pararendës të autorit. Ja një shembull definimi impresiv poetik:

*Dashuria është si trëndafil i bardhë
Me trup të drejtë
Dashuria është si zjarri i ndëshkimit
Me shumë të panjohura
Dashuria është si gjumi i shpirtave
Në mesnatën e lumturisë*

(“Dashuria”, *Kushtuar atyre që dinë çdo gjë për dashurinë*)

Nëse do të bëja një klasifikim të vogël të poezive antologjike të këtij vëllimi, në të do të përfshija këto poezi, ose vepra të veçanta artistike, (këtu sërish ripajtohem me Shtajgerin): “Bukuria”, “Të jesh vetëm poet”, “Gjethet s’bien gjithmonë në tokën e vet”, “Si lind poezia për ty”, “Liria”, “Ideali i dyfishtë”, “Askush nuk i duron poetët”, “Njësoj si sytë e tu”, po edhe disa të tjera nga ky vëllim voluminoz.

Një vëllim poetik që ka kaq poezi antologjike brenda dy kopertinave, ia vlen të lexohet qoftë dhe vetëm për to. Ndonëse në rastin e këtij libri, i tëri është i këndshëm për lexim dhe ofron një përjetim mirëfilli artistik. Bile në këtë kontekst, poezia e Bashotës ende ka mbetur me njërin këmbë jashtë ligjërimit postmodernist, i cili zakonisht është më eksplicit, më sipërfaqësor, më vulgar, më pak domethënës e më pak mbresëlënës. Shumica e poezive të tij përshkohen nga poetizma dhe figura që prodhojnë emocion, ndjeshmëri morale dhe përjetim estetik.

Si lexues i vëllimit deri sa ishte në dorëshkrim, e kam lexuar me sytë e mi e jo me sytë e autorit. Aq më pak me sytë e lexuesve të ardhshëm. Prandaj, leximi im që po u ofrohet këtu si parathënie, mund të jetë një urë lidhëse ndërmjet autorit dhe lexuesve, por kjo nuk është fare e domosdoshme. Lexojeni vetë, përjetojeni vetë. Ndërsa autori më nuk ka të bëjë me mënyrën se si ne e lexojmë dhe e vlerësojmë poezinë e tij. Ai ka bërë mjaft, na e ka afuar mundësinë që të komunikojmë me të. Kjo është zemërgjerësia e poetëve të vërtetë, të cilën komunikuesit e tjerë, nuk e kanë në këtë formë e në këtë nivel.

(Parathënia e librit: Sali Bashota, “Lutja e parë e shpirtit”, ISBN 978-9951-457-50-7, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2020)

A ËSHTË REDAKTIMI ART I HUMBUR?

nga Nick Ritrapazone

“Mësuesi i shkëlqyer është dhuratë. Redaktori i shkëlqyer është mrekulli.”

“Bagazh i panevojshëm”, kështu i përshkroi Albert Erskine, redaktori i romanit “Suttree” të Cormac McCarthy-t, disa pjesë që në dorëshkrimin e dorëzuar nuk kishin ritëm. McCarthy e dëgjoi. Ai kaloi muaj duke e rishikuar dhe duke e shkurtuar librin. Erskine-t mund t’i besohej sepse kishte redaktuar veprën e tij që nga romani i parë në vitin 1966, “Përkujdesësi i pemishtes”. Më përpara, ai kishte redaktuar veprat e William Faulkner-it. Karrierën si redaktor e kishte nisur në korrik, kur u bë bashkëthemelues i revistës letrare “The Southern Review”.

Erskine ishte caktuar si menaxher biznesi, por menjëherë nisi të përzgjidhte dhe redaktonte prozën e revistës. Botoi tregime të shkrimtarëve Katherine Anne Porter, Caroline Gordon, dhe Eudora Welty. Vite më vonë, Erskine e ndihmoi Welty-in për të redaktuar romanin e saj të fundit, “Beteja të humbura”. “Më priti në shtëpi si mysafire,” kujtonte ajo, “hanim ushqim të mrekullueshëm dhe kalonim shumë këndshëm, dhe çdo ditë uleshim në tryezë për ta rishikuar dorëshkrimin e gjatë, rresht pas rreshti”.

Erskine diskutonte dhe ndërmmjetësonte për çdo fjali. Ai i tha Faulkner-it se përdorte sinonime të tepërta. Robert Penn Warren-it i kërkoi të përcaktonte llojin e gjinkallave që përmendte. Redaktoi romanin “Njeriu i padukshëm” të Ralph Ellison-it, dhe romancieri u ankua në një letër se “Erskine ka kohë që kërkon të përcaktoj se çfarë lloj romani është, dhe unë s’kam ç’të bëj”. Erskine dhe Ellison-i e redaktuan së bashku romanin, duke e lexuar dorëshkrimin me zë të lartë, për të dëgjuar si tingëllonte. Redaktorët e tekstit i bëjnë të dyja, i inatosin por edhe i shpëtojnë shkrimtarët.

Dualiteti lind nga fjala: rresht. Rreshti nënkupton

një domethënie të ndryshueshme por njëkohësisht tipografike. Një rresht është poetik dhe ka kuptim të fjalë për fjalshëm ku shpresa e qëllimit përmbushet në realitetin e faqes. Redaktimi rresht pas rreshti është bashkimi themelor midis shkrimtarit dhe redaktorit. Ky lloj redaktimi do të thotë se ne i heqim kontrollin dhe stilolapsin, dikujt tjetër. Është akt besimi dhe duhet të jetë i ndërsjelltë.

*

Joseph Heller u shpreh një herë për “The Paris Review” se redaktori i tij, Robert Gottlieb, mendonte se “ishte turp” që lexuesit i duhej të priste shumë gjatë derisa të arrinte tek një kapitull i veçantë i romanit “Catch-22”. Heller “shkurtoi afërsisht 50 ose 60 faqe nga fillimi vetëm që tek ai kapitull të arrihej më shpejt”. Gottlieb-i, megjithatë, parapëlqeu të mos përfshihej në diskutimin publik të librave që redaktonte, sepse mendonte që “marrëdhënia e redaktorit me një libër duhet të jetë e padukshme”.

Të gjithë ata që merren me këtë punë, e dinë se librat nuk janë sipërmarrje vetëm e një individi. Toni Morrison, e cila u redaktua gjithashtu nga Gottlieb-i, tha se ajo kurrë nuk ka shkruar “duke pasur Robertin në mendje, sepse kjo do të kishte ndikim shumë negativ tek ajo. Ai nuk është lexuesi ideal për krijimet e saj, por ishte redaktori ideal për të. “Redaktorët e tekstit nuk janë lexues në kuptimin publik; janë ushtrues privat të zejes, dhe profesioni i tyre mbështetet tek ndjenja e besimit ashtu si tek autoriteti i gjykimit. Gottlieb-i e quan marrjen e dorëshkrimit të një shkrimtari si veprim që bën “zhvendosjen emocionale”. Ditët dhe javët që kalojnë para se autori ta rimarrë dorëshkrimin e redaktuar janë të shumta dhe pritja e gjatë, por shkrimtarët e dinë që ia vlen të presësh redaktorin

e tekstit tënd, ia vlen ta durosh edhe ngarkesën emocionale.

Redaktorët e tekstit si përmbajtje (Line editors) shpesh ngatërrohen me redaktorët e tekstit si formë (Copy editors). Të parët merren me stilin, gjuhën e përdorur në nivel fjalie dhe paragrafi, përqendrohet tek mënyra e përdorimit të saj për të komunikuar me lexuesin, nëse arrin të krijoj atmosferën, emocionin, dhe tonin. Ndërsa të dytët priren t’i japin dorën e fundit dhe ta përsosin veprën në një fazë të mëvonshme, por vetë kjo ngatërresë mes punës që duhet të bëjë secili është shumë domethënëse. Ata duhet të merren me mangësitë në nivel teknik, drejtshkrimin, pikësimin, sintaksën, përputhjen e fakteve, vijmësinë e subjektit, mjedisit, tipareve të personazheve që shkrimi të jetë i qartë dhe i saktë.

George Witte, kryeredaktor i “St. Martin’s Press”, thotë se “shumica e redaktorëve të tekstit si formë bën punën e redaktorit të përmbajtjes”. Redaktimi i formës bëhet pa krijuar marrëdhënie ndërveprimi me autorin, por në rastin e Erskine-t me Ellison-it, Gottlieb-it me Heller-in, redaktorët e përmbajtjes kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me shkrimtarin. Sipas Witte ata janë “lexuesi ideal” i librit, sepse redaktojnë vepra të ndryshme të shkrimtarit për një kohë të gjatë, duke u shndërruar në “burimin e fitimeve, pikën e kontaktit, udhëzuesin gjatë procesit të botimit, në tifoazin e zjarrit dhe avokatin e tij, personin të cilit shkrimtari mund t’i shpreh shqetësimet, ose, ndoshta, edhe të takohet gjatë drekës apo ta shoqërojë në pije, ndonjëherë mik, dhe para së gjithash lexuesi më i vëmendshëm dhe më i ndershem i veprës së një autori”.


Redaktorët e përmbajtjes i tendosin fjalitë atëherë kur mugon tensioni dhe qartësia, por gjithashtu u japin frymëmarrje atëherë kur ato kufizohen. Përtej heqjes së frazave klishe, ata mënjanojnë fjalët e përdorura me tepri nga shkrimtari dhe disa struktura të caktuara fjalish. Redaktorët e tekstit ndihmojnë që fjalitë të ndërtohen në paragrafë dhe paragrafët të lexohen rrjedhshëm në faqe. Ata mbajnë të bashkuar syrin dhe veshin e shkrimtarit. Por një redaktor teksti, i cili ka alergji nga lëvdatat, dhe vetëm mban në dorë një çekiç, mund të shkatërojë jo vetëm një dorëshkrim. Akoma më keq, mund të lëndojë një shpirt.

*

Dorëshkrimet dhe shpirtrat shpesh shpëtohen nga redaktorët e tekstit si përmbajtje. Kur Ernest Hemingway i nisi në tetor 1949 një letër Charles Scribner-it, ai ishte në gjendje të mirë shpirtërore: “Në djall shkrimi sot”. Pastaj shprehet për redaktorin Maxwell Perkins dhe romancierin Thomas Wolfe: “Nëse Max-i nuk do të kishte shkurtuar dhjetë tonë pleh nga romani i Wolfe-it, të gjithë do ta dinin që pas librit të parë se sa shkrimtar i dobët është. Por tani nuk e di kush, vetëm miqtë e afërt si unë ose ata me të cilët pi verë. “Vite më parë, Hemingway e kishte paralajmëruar Perkins-in për personalitetin e tij: “Ju lutem ta dini se kur jam i zhurmshëm, i hidhur, i vrazhdë, nuk bindem dhe jam mosbesues, atëherë në të vërtetë jam shumë i arsyeshem dhe kam besim të madh, kam besim absolut tek ju”.

Në disa ese për “The Guardian”, Blake Morrison dhe Alex Clark kanë shkruar shënime elegante për redaktime të tilla teksti. Morrisoni e identifikon periudhën 1912-1925 si “epokën e artë të redaktimit”, por mendon se arti i redaktimit të kujdesshëm të tekstit në fund të fundit pësoi kishte një vdekje praktike bashkëkohore. Ai thotë se shumica e botuesve mendojnë se redaktorët duhet të jenë më të shkathët tani; duhet të jenë “persona të gjithanshëm, të përfshirë në promovime, veprimtari publicitete dhe në procesin e shitjes”. Agjentët letrar kanë zëvendësuar redaktorët; agjentët “u ofrojnë autorëve qëndrueshmëri”, ndërsa redaktorët “janë shtegtues, zhvendosen nga një shtëpi botuese tek tjetra”. Clark i bën jehonë kësaj ndjenje, duke pyetur veten “nëse imazhi i redaktorit idengulitur





pas fjalës, i zhytur në tekstin e një dorëshkrimi, me stilolaps të kuq në dorë, i ka hapur rrugë sipërmarrësit të zot që i përshtatet kapriços më të fundit të tregut, i cili di më shumë çfarë të shkruaj në Twitter se sa çfarë është metafora”.

E vërteta dhe historia janë të ndërlikuar. Autori i letërsisë fantastiko-shkencore Samuel Delany pasi reflektoi mbi karrierën e tij që nisi në vitin 1962 dhe vazhdon deri sot, arriti në përfundimin se ai ka pasur vetëm një redaktor të vërtetë teksti letrar, Ron Drummond-in. Delany mendon se “leximet maratonë” që bëjnë redaktorët e shtëpive të ndryshme botuese “prirën t’i topisin edhe ndjeshmëritë më të holla të nevojshme për të hyrë brenda një teksti, për t’i ndjerë ato nga brenda në mënyrë që të jepen sugjerime të dobishme për përmirësime të cilat shkrimtari i dëgjon dhe pastaj reagon”. Mënyra e tyre e leximit është një vendim: ky libër funksionon, do të shitet. Për Delany-n, kjo mënyrë leximi është e ngjashme me stilin kritik që përdoret në një seminar shkrimi krijues, në të cilin “librat kategorizohen në përgjithësi sipas efektit që krijojnë, më shumë se sa në lidhje me të veçantën dhe ndjeshmërinë e arsytuar. Këto lexime kritike nuk janë të pavlefshme, por ato “marrin parasysh kujtesën e tekstit, jo përvojën aktuale të leximit të tekstit e cila është ajo çfarë shkrimtari e modelon gjithmonë pak a shumë me zotësi ndërsa shkruan”.

Ajo që sugjeron Delany, dhe çfarë duket e vërtetë për Erskine-n, Gottlieb-in dhe redaktorët e tjerë të tekstit si përmbajtje që vazhdojnë të redaktojnë, është të jesh redaktori-lexues, i vetëm, kritik, i cili zhvillohet dhe rritet me shkrimtarin. Në vend që ta shohim redaktimin e tekstit si art i harruar, të konsumuar pa mëshirë nga biznesi i librit, duhet ta shohim si privilegj, një dhuratë, të cilën e kanë shijuar disa shkrimtarë, por jo pjesa më e madhe e tyre. Rust Hills, redaktori i prozës se “Esquire” para dhe pasi Gordon Lish tha se “midis të mësuarit të tjerëve shkrimin krijues dhe redaktimi të revistave letrare ka shumë dallime të çuditshme”, por “të dyja kanë të njëjtin qëllim përfundimtar të çuditshëm: përpjekjen që të bësh dikë tjetër të krijojë një rrëfim të mirë”. Redaktori i tekstit njësoj, si mësuesi dhe udhërrëfyesi, ndihen si një metaforë e dobishme, dhe ajo që e kam përjetuar vetë.

Shigjetat e lakuara të bëra me stilolaps mbushin faqen. Kryqet fshijnë fjalët shtesë. Pyetjet rreshtohen në skaj të faqes. Njollat e zeza duken kudo në dy faqe, me një shpjegim: “ma harxhove bojën!” Redaktimet me ngjyrë blu nuk janë më të këndshme: “e panevojshme”; “forma pësore”; “ku jemi këtu?” Një shënim përmbyllës shkruhet në pjesën e pasme të dy faqeve, duke u hapur me disa lëvdata të shkurtra, por më pas përkapin

shpirtin e historisë së rrëfyer.

Mësuesi i shkëlqyer është dhuratë. Redaktori i shkëlqyer është mrekulli. Jayne Anne Phillips i kishte të dyja. Kopjet e saj të mbushura me shënime të dorëshkrimeve të mia ishin mësim të përmbledhura në aspektin e formës dhe funksionit. Ulesha në zyrën e saj në Rutgers-Newark dhe merresha me çdo vërejtje. Ajo kishte leksione me studentët një orë para seminareve tona. Dhe bisedat tona nuk ishin biseda sipërfaqësore; Jayne Anne bëri vërtetë punë të mirë. Ajo u mor me të gjitha tregimet, fjali pas fjalie, paragraf pas paragrafi dhe faqe pas faqeje. Ajo më foli për tregimet e mia, skenat jo të arrira, skenat ambicioze, si çështje që kishin rëndësi për të. Ne e respektonim. Ajo na trembte, jo sepse tregohej e padrejtë, por sepse ishte shkrimtare kaq e talentuar.

Ashtu si Jayne Anne, profesoresha ime e letërsisë në universitet ishte rritur në Virxhinian Perëndimore, dhe ne e lexuam prozën e saj të shkurtër përpara vizitës në kampin e universitetit por më tërhoqi “Biletat e zeza”. Libra të tjerë do të më rrëmbenin: “Në zemrën e zemrës së vendit” i William H. Gass-it, romani “Marianne e dalldisur” e Ron Hansen-it, përmbledhja me tregime “Britmë dhe vaj” e James Alan McPherson-it, por “Biletat e Zeza” ishte i pari ndër to. Të gjithë shkrimtarët kanë nevojë për një libër që i bën të besojnë se fjalët kanë rëndësi. Libri i saj më bëri ta besoj këtë. “E di, hasa rrugës këtë fermerin plakush e të poshtër në një bar mbrëmë. Më tha se po e shiste kamionin për dy kacidhe dhe se mund të veja në La Rosa për ta marrë”. Fjalitë e para të romanit të Winston Groom-it “El Paso” më tërhoqën aty për aty vëmendjen. Fjalitë e saj më goditën, me detaje që vërshonin: “Duke ecur në oborrin e pluhurt, nëpër goma të vjetra dhe ndanë sustës së një shtrati të kalbur, një mushkë rrinte e lidhur tek një pompë afër kotecit, dhe ai u ndal më në fund tek njëfarë makine Shevrolet e viteve 50-të, me një shtrojë të sajuar ku ishin vendosur kafazë pulash. Kryqe dhe një kukull e nxirë, çelësa të varur në një kordele flokësh”. Ishte një botë e krijuar me detaje të sakta dhe të pazakonta.

Disa vjet më vonë, kur mësova se Jayne Anne kishte themeluar programin universitar të arteve në Rutgers-Newark, u detyrova të aplikoj. Ajo ishte drejtoreshë e programit dhe jepte mësim në seminarin e shkrimit krijues. Më pëlqente tej mase të isha në orët e saj të mësimin. Lexuam “Syri më blu” të Toni Morrisonit, “Fat City” të Leonard Gardner-it, dhe ajo na tregoi këngët e rreshtave të tyre. Rreshtat ishte fjala që përdorte për të përshkruar fjalinë. Pavarësisht nga mënyra si ishin ndërtuar, fjalitë duhej të ishin drejtvizore dhe të rrjedhshme. Kryefjalë, folje, kundrinor.

Një mësues i shkrimit krijues mund të të mësojë

shumë gjëra, por më e rëndësishmja është përkimi i ushtrimit dhe misterit. Jayne Anne na mësoi teknikën pa e asgjësuar artin. Kohët e fundit e pyeta për metodën e saj të leximit të dorëshkrimeve të studentëve. “Epo atëherë më duhet të të flas për redaktimin e tekstit si përmbajtje, sepse unë e bëj me intuitë,” thotë ajo. “E shoh një rresht dhe e di menjëherë se çfarë ndryshimesh duhen bërë, çfarë duhet fshirë, frazat që duhen hequr, çfarë e bën më të mirë, më të fortë, më të thukët. Qartësia, kuptimi, domethënia, siç ka thënë Frank Conroy (gjithashtu një mësues i redaktimit të tekstit) për studentët e tij të universitetit. Natyrisht, është më e vështirë të redaktosh veten, por (nganjëherë) s’e pengoj dot veten të mos lexoj atë që është botuar me syrin e redaktorit”.

Jayne Anne ishte mësuesja e parë që më bindi se të gjitha redaktimet e vërteta ndodhin në faqen e shtypur. Është e nevojshme ta prekim një dorëshkrim, ta ndiejmë atë si të vërtetë, përpara se ta bëjmë diçka më të mirë. Ajo thotë se “studentët zakonisht e kuptojnë shumë shpejt nëse një redaktim teksti është i dobishëm. Është sikur rreshti gjen vendin e vet ose sinkronizon ritmin. Shkrimtarët e vërtetë fillojnë ta brendësojnë atë vëmendje ndaj rreshtit, ndaj një lloj fraze muzikore, ndaj kumbimit të rrokjes, ndaj çastit kur duket qartë se duhet vënë pikë”.

Metoda që ajo përdor më çon sërish tek zyra e saj në Newark, ku mësova se redaktimi nuk është diçka që ne bëjmë tek ajo që është shkruar; redaktimi është shkrim. “Gjatë redaktimit depërton tek paragrafi, historia, gjatë gjithë romanit”, - thotë Jayne Anne, “dhe rreshti në fletë është themeli i të gjithave, plotësisht i dukshëm dhe i pranishëm, pavarësisht sa i errët është qëllimi, i cila shpesh është vetëm ajo që ne mendojmë se dimë për atë që po përpiqemi të shkruajmë”.

“Qëllimi mund të bëjë një bisedë interesante, por nuk shkruan një libër. Shumë shpesh të shkruarit është shkëndijues, tingëlues, erëmues, shkëlqimtar, me qëllimin për të na tërhequr më fort si shkrimtarë, por ne e bëjmë këtë nëpërmjet rreshtit”. Kur merrja sërish dorëshkrimet nga Jayne Anne, faqet ishin të mbushura me shënime, ato ngjanin më të rënda, të vjetëruara. Ajo hynte në rrëfimet e mia nëpërmjet rreshtave, dhe i jam përgjithmonë mirënjohës. Saxe Commins, redaktori për një kohë shumë të gjatë i Faulkner-it, e ndihmoi romancierin si profesionalisht ashtu edhe personalisht. Përshkrimi i Faulkner-it për marrëdhëniet e tyre përkap lidhjen e ndërlikuar midis shkrimtarit dhe redaktorit: “Asnjëherë s’kishim të njëjtin mendim, por gjithmonë sinonim të njëjtën gjë”.

Jacques Attali
Pierre-Henry Salfati



Fati
i perëndimit
Athinë, Jeruzalem

Minerva